



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 170

Tiranë – E premte, 13 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 11.12.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar..... 13065
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 785, datë 11.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara”, të ndryshuar..... 13065
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 11.12.2019	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut..... 13072
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 11.12.2019	Për përcaktimin e kriterëve dhe të masës së shpërblimit financiar mujor të familjeve të dëshmorëve të atdheut..... 13072
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 11.12.2019	Për përbërjen dhe rregullat e detajuara për organizimin, funksionimin e shpërblimit financiar të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”..... 13073
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 11.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 400, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian, me mision trajnues, në Republikën e Malit, në Afrikë”, të ndryshuar..... 13075
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 790, datë 11.12.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim blloqesh banimi, rruga ‘Shaban Bushati’, në Bashkinë Shkodër”..... 13075
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 791, datë 11.12.2019	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për konvertimin e borxhit për zhvillim, ratifikuar me ligjin nr. 10473, datë 27.10.2011..... 13076

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 11.12.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë të rënë gjatë Luftës Greko-Italiane të viteve 1940–1941” dhe për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në tokë urbane “truall/varreza”, të pasurive me nr. 364/20 dhe nr. 364/21, zona kadastrale 2131, në Këlcyre.....	13079
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 11.12.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1148, datë 25.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rruga hyrëse Fier’”, të ndryshuar.....	13082
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 11.12.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga e Arbrit”.....	13084
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 11.12.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.....	13087
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 799, datë 11.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 170, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1 000 000 000 (një miliard) lekë në programin ‘Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit’”.....	13087
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 800, datë 11.12.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 237, datë 6.3.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve”	13088
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 801, datë 11.12.2019	Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e publikut dhe të punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues, dhe sigurisë ndaj ekspozimeve mjekësore me burimet e rrezatimit jonizues.....	13092
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 802, datë 11.12.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 46, datë 30.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019”, të ndryshuar.....	13149
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 11.12.2019	Për lirim nga detyra.....	13151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 11.12.2019	Për emërim në detyrë.....	13151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 805, datë 11.12.2019	Për emërim në detyrë.....	13151

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 11.12.2019	Për emërim në detyrë.....	13151
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Andrea Ndreka.....	13151
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Fatmir Beqiri.....	13151

**VENDIM****Nr. 784, datë 11.12.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË
DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1/3, të vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “a”, emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe shtohet emërtesa “Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë”;

b) Në fund të shkronjës “b” shtohet emërtesa “Agjencia Kombëtare e Pyjeve”.

2. Zbatimi i këtij vendimi dhe efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij, për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara, përkatësisht për sistemin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sistemin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe sistemin e Ministrisë së Arsimit,

Sportit dhe Rinisë e të fillojnë nga momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve/punonjësve në strukturën dhe organikën e re të secilit institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM**Nr. 785, datë 11.12.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 654, DATË 14.9.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË
AGJENCISË SË OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 654, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shtojca I, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.


2. Shtojca II, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Numri i punonjësve të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të jetë, gjithsej, 175 veta.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe





ORGANIGRAMA E AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

	KATEGORIA	POZICIONI
I. DREJTOR EKZEKUTIV (TITULLAR I INSTITUCIONIT)	II- a	1
SEKTORII AUDITIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
SEKTORII KËRKIMIT DHE INOVACIONIT/ADISA LAB		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
II. DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË QENDRAVE		(12)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORII PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TE PROJEKTEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	2
SEKTORII KOMUNIKIMIT ME QYTETARIN		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3



III. DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË BRENDSHËM	(15)
DREJTOR	II-b 1
SEKTORI JURIDIK	(3)
PËRGJEGJËSEKTORI	III-a/1 1
SPECIALIST	IV-a 2
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHETËSE	(4)
PËRGJEGJËSEKTORI	III-a/1 1
SPECIALIST	IV-a 1
PUNONJËSE PASTRIMI	I 1
MAGAZINIER/MIRËMBATJE	VI 1
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLLIT	(4)
PËRGJEGJËSEKTORI	III-a/1 1
SPECIALIST	IV-a 2
SPECIALIST ARKIV-PROTOKOLL	IV-b 1
SEKTORI I TRAJNIMEVE DHE MENAXHIMIT TË NJOHURIVE	(3)
PËRGJEGJËSEKTORI	III-a/1 1
SPECIALIST	IV-a 2
IV. DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE SHERBIMEVE	(13)
DREJTOR	II-b 1



SEKTORI I RI-INXHIERIMIT DHE MARRËDHENIEVE INSTITUCIONALE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	(4) 1 3
SEKTORI I ZHVILLIMIT TË STANDARDEVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	(3) 1 2
SEKTORI I PERFORMANCËS DHE STATISTIKAVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	(5) 1 4
V. DREJTORIA EKONOMIKE	(10)
DREJTOR	1
SEKTORI I FINANCËS PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	(3) 1 2
SEKTORI I INVESTIMEVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	(3) 1 2
SEKTORI I PROKURIMEVE PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	(3) 1 2



VI. ZYRRAT RAJONALE/VENDORE			(118)
ZYRA RAJONALE TIRANË			
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b		1
SPECIALIST	IV-b		22
PUNONJËSPASTRIMI	I		2
SHOFER	IV		1
MIRËMBAJTËS	IV		1
ZYRA VENDORE KAVAJË			(10)
PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a		1
SPECIALIST	IV-c		8
PUNONJËSPASTRIMI	I		1
ZYRA RAJONALE FIER			(19)
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b		1
SPECIALIST	IV-b		16
PUNONJËSPASTRIMI	I		1
SHOFER	IV		1
ZYRA VENDORE KRUJË			(9)
PËRGJEGJËS ZYRE	IV-a		1
SPECIALIST	IV-c		7
PUNONJËSPASTRIMI	I		1
ZYRA RAJONALE GJIROKASTËR			(13)
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b		1
SPECIALIST	IV-b		10
PUNONJËSPASTRIMI	I		1
MIRËMBAJTËS	IV		1
ZYRA RAJONALE SHKODËR			(14)
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b		1



SPECIALIST	IV-b	11
PUNONJËSPASTRIMI	I	1
SHOFER	IV	1
ZYRA VENDORE MALIQ		(2)
PËRGJEGJËSZYRE	IV-a	1
SPECIALIST	IV-c	1
ZYRA VENDORE LUSHNJE		(9)
PËRGJEGJËSZYRE	IV-a	1
SPECIALIST	IV-c	7
PUNONJËSPASTRIMI	I	1
ZYRA RAJONALE ELBASAN		(13)
PËRGJEGJËSZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	11
PUNONJËSPASTRIMI	I	1
ZYRA RAJONALE KUKËS		(2)
PËRGJEGJËSZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	1

**VENDIM****Nr. 786, datë 11.12.2019****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE TË PROCEDURAVE PËR
NDËRTIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
RUAJTJEN E VARREZAVE TË
DËSHMORËVE TË ATDHEUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shenjë nderimi, përkujtimi dhe mirënjohjeje kombëtare për dëshmorët e atdheut ndërtohen varreza ku prehen dëshmorët e atdheut.

2. Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe, si të tilla, trajtohen e mbrohen si monument kulture, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimin publik të varrimit dhe për trashëgiminë kulturore e muzetë.

3. Varrezat e reja, të cilat do të shërbejnë si vend prehjeje për personat që gëzojnë statusin “Dëshmor i atdheut”, krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Deklarimi pasuri kulturore i varrezave të reja, që gëzojnë statusin “Dëshmor i atdheut”, bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore e muzetë. Administrimi i vlerave kulturore të varrezave monumentale bëhet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

5. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë institucionet përgjegjëse për projektimin dhe ndërtimin e varrezave të reja të dëshmorëve të atdheut. Projektimi dhe ndërtimi bëhen kundrejt fondeve buxhetore që do të akordohen rast pas rasti.

6. Mirëmbajtja dhe ruajtja e varrezave të dëshmorëve të atdheut kryhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

7. Në çdo varrezë të dëshmorëve të atdheut përcaktohen shërbimet e ruajtjes, të kontrollit dhe të kujdestarisë gjatë gjithë kohës së funksionimit të

tyre, sipas akteve ligjore në fuqi për administrimin e varrimit dhe për trashëgiminë kulturore.

8. Ndërtimi, zgjerimi, mbyllja apo prishja e varrezës së dëshmorëve të atdheut apo e parcelave ku gjenden varret e dëshmorëve të atdheut bëhet në pajtim me projektin për zhvillimin e varrezave të dëshmorëve dhe planin e përgjithshëm vendor të zhvillimit urban, si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Në çdo rast, projekti kalon për shqyrtim e miratim pranë strukturave kompetente të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

9. Në rastet kur normat e radioaktivitetit janë tej normave të lejuara, atëherë mbetjet mortore të personit të shpallur “Dëshmor i atdheut” do të trajtohen sipas rregullave ligjore e teknike për mbrojtjen nga rrezatimet radioaktive, në bashkëpunim me organet kompetente.

10. Materialet e gërmuara dhe mbeturinat e dala gjatë meremetimit dhe ndërtimit të varreve të reja në varrezën e dëshmorëve të atdheut duhet të transportohen jashtë varrezave jo më vonë se një ditë pas datës së përfundimit të punimeve. Materialet për kryerjen e punimeve të ndryshme duhen të jenë të parapërgatitura dhe të vendosen në zona të miratuara nga struktura përkatëse të bashkisë.

11. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Kulturës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****VENDIM****Nr. 787, datë 11.12.2019****PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË MASËS SË SHPËRBLIMIT
FINANCIAR MUJOR TË FAMILJEVE TË
DËSHMORËVE TË ATDHEUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Shpërblimi financiar mujor për familjen e dëshmorit të atdheut caktohet në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë.

2. Kur përfitues të shpërblimit financiar, sipas certifikatës së rrethit familjar të dëshmorit të atdheut në momentin e vdekjes së tij, janë më shumë se një person, atëherë personi që do të tërheqë këtë shpërblim duhet të pajiset me prokurë të lëshuar nga përfituesit e tjerë.

3. Në njoftimin e dhënies së statusit “Dëshmor i atdheut” nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” (KQSDA), përfituesit duhet të informohen, gjithashtu, edhe në lidhje me procedurën dhe dokumentacionin që kërkohet për të përfituar shpërblimin financiar.

4. Në rast se përfituesit, sipas certifikatës së rrethit familjar të dëshmorit të atdheut në momentin e vdekjes së tij, brenda 10 ditëve, nga njoftimi i dhënies së statusit “Dëshmor i atdheut” nga KQSDA, nuk bien dakord për pajisjen me prokurë të njërit prej tyre, atëherë masa e shpërblimit financiar mujor do të pjesëtohet sipas numrit të përgjithshëm të përfituesve.

5. KQSDA-ja i dërgon Institutit të Sigurimeve Shoqërore emrin e familjarit, që, sipas certifikatës së gjendjes familjare të dëshmorit të atdheut në momentin e vdekjes së tij, përfiton shpërblimin financiar, bashkë me një kopje origjinale të vendimit për dhënien e statusit “Dëshmor i atdheut”.

6. Kur familjari i autorizuar, sipas listës dhe vendimit të KQSDA-së për tërheqjen e shpërblimit, vdes, kjo e drejtë i transferohet njërit prej pjesëtarëve të rrethit familjar, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi.

7. Shpërblimi i familjes së dëshmorit të atdheut jepet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas vendimit të KQSDA-së.

8. Trajtimi financiar për rrethin familjar të dëshmorit të atdheut fillon në datën e shpalljes së vendimit të KQSDA-së.

9. Trajtimi financiar për rrethin familjar të dëshmorit të atdheut, i cili e ka fituar të drejtën për t’u njohur si “Dëshmor i atdheut” me vendim gjykatë të formës së prerë, fillon nga data e vendimit të komisionit për mosdhënien e statusit “Dëshmor i atdheut”.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe fillojnë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 788, datë 11.12.2019

**PËR PËRBËRJEN DHE RREGULLAT E
DETAJUARA PËR ORGANIZIMIN,
FUNKSIONIMIN E SHPËRBLIMIT
FINANCIAR TË KOMISIONIT
QENDROR TË STATUSIT
“DËSHMOR I ATDHEUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 5, të nenit 10, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranë Ministrisë së Mbrojtjes krijohet Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut”, që kryesohet nga ministri i Mbrojtjes (kryetar), zëvendësministri i Mbrojtjes (nënkryetar) dhe në përbërje ka anëtarë:

- zëvendësministrin e Brendshëm;
- zëvendësministrin e Drejtësisë;
- zëvendësministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- një përfaqësues të Organizatës së Dëshmorëve të LANÇ-it dhe dëshmorëve të tjerë të atdheut;
- një përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it.

2. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” mbështetet nga një staf teknik, që funksionon pranë Ministrisë së Mbrojtjes, përbërja dhe organizimi i të cilit përcaktohet nga ministri i Mbrojtjes. Përgjegjësi i këtij stafi ushtron



funkSIONET e sekretarit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”.

3. Marrja e vendimeve të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut” do të kryhet sipas dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

4. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” mbliDhet me kërkesën e kryetarit të komisionit dhe ushtron këto detyra:

a) shqyrton dhe merr vendime lidhur me propozimin dhe dokumentacionin për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, të dërguar nga subjektet propozuese;

b) shqyrton dhe merr vendim lidhur me ankesat administrative të subjekteve kërkuese kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit, të cilët kanë refuzuar kërkesën e tyre për statusin e dëshmorit të atdheut ose kur këto organe nuk kanë marrë në shqyrtim kërkesën e tyre për këtë çështje, brenda afateve të parashikuara ligjore;

c) njofton me shkrim subjektin propozues apo subjektin ankues se propozimi ose ankesa e tij është pranuar për vazhdimin e procedurës administrative nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” ose për plotësimin e të metave lidhur me kriteret formale, ligjore, të propozimit, duke caktuar një afat prej 10 ditësh pune për plotësimin e këtyre të metave;

ç) njofton subjektin propozues apo subjektin ankues se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative, para se të vendosë pranimin ose jo të propozimit apo të kërkesës/ankesës, duke caktuar një afat prej 10 ditësh pune për kryerjen e këtyre veprimeve;

d) bashkëpunon me organet shtetërore qendrore e vendore dhe me organizatat e dëshmorëve apo organizata të tjera për organizimin e ceremonive të dhënies (shpërndarjes) së certifikatës “Dëshmor i atdheut” dhe të simbolit “Familje e dëshmorit të atdheut”;

dh) rishqyrton vendimet e tij, të cilët, bazuar në një vendim gjykatë të formës së prerë, janë anuluar apo shfuqizuar;

e) miraton, me vendim, dhënien e shpërblimit financiar mujor për familjen e dëshmorit të atdheut, kur plotësohen kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 18, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”;

ë) bashkëpunon me institucionet e tjera publike gjatë hetimit administrativ të një çështjeje për shpalljen apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”;

f) ngarkon stafin teknik të komisionit qendror me detyra specifike administrative, për çështjen që shqyrton;

g) njofton, me shkresë zyrtare, subjektin propozues apo subjektin ankues, brenda afateve ligjore, për vendimin përfundimtar të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”;

gj) merr vendim për delegimin e disa kompetencave nënkryetarit, një anëtarit apo stafit teknik të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”.

5. Propozimi për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” përmban identitetin e plotë e të saktë të të ndjerit, jetëshkrimin të tij dhe përshkrimin e saktë të rrethanave të ngjarjes ku ka humbur jetën, sipas dokumenteve zyrtare, shtetërore dhe çdo dokumentacion tjetër, të përcaktuar sipas nenit 8, të ligjit nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, dhe i paraqitet këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose prefektit.

6. Propozimi për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” paraqitet pranë stafit teknik të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, në Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Komisioni Qendror, për dhënien e statusit “Dëshmor i atdheut”, shqyrton dokumentet e dërguara nga këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, prefekti ose ministri përkatës dhe relacionin e stafit teknik. Komisioni Qendror merr vendimin brenda 3 muajve, nga dita e regjistrimit në sekretarinë e këtij komisioni, për shpalljen ose jo “Dëshmor i atdheut” të të ndjerit dhe njofton të interesuarin nëpërmjet këshillit të qarkut, këshillit bashkiak dhe prefektit.

8. Vendimi i Komisionit Qendror për mosdhënien e statusit “Dëshmor i atdheut” duhet të jetë i arsyetuar.

9. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas përcaktimeve në vendimin normativ të masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore.

10. Vendimi nr. 151, datë 25.5.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për statusin ‘Dëshmor i Atdheut’”, shfuqizohet.



11. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 789, datë 11.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 400, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË BASHKIMIT EVROPIAN, ME MISION TRAJNUES, NË REPUBLIKËN E MALIT, NË AFRIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 103/2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për krijimin e kuadrit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian”, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 400, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikat 1, shkronja “b”, dhe 3, data “... 31 dhjetor 2019 ...” ndryshohet dhe bëhet “... 31 dhjetor 2021 ...”.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 790, datë 11.12.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SISTEMIM BLOQESH BANIMI, RRUGA ‘SHABAN BUSHATI’, NË BASHKINË SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim blloqesh banimi, rruga ‘Shaban Bushati’, në Bashkinë Shkodër”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronari i pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 500 (pesëqind) m², me vlerë të përgjithshme prej 4 255 500 (katër milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 255 500 (katër milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Shkodër, planifikuar në buxhetin e saj, me vendim të këshillit bashkiak.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.



6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur pranë Bashkisë Shkodër certifikatën e pronësisë, hartën treguese të regjistrimit, si dhe kartelën e pasurisë.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shkodër.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së

shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Shkodër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

**LISTA E PRONAVE DHE E PRONARIT QË DO TË SHPRONËSOHET PËR PROJEKTIN
“SISTEMIM BLOQE BANIMI RRUGA ‘SHABAN BUSHATT’, BASHKIA SHKODËR”**

Nr.	Emër mbiemër (pronari që shpronësohet)	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Vol.	Faqe	Sipërfaqja e truallit që shpronësohet/m ²	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit/lekë	Shënime
1	Artan Perit Salihi	8591	4/1072	56	36	500	8,511	4,255,500	Konfirmim nga ZVRPP-ja
	Totali							4 255 500	

VENDIM

Nr. 791, datë 11.12.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR
KONVERTIMIN E BORXHIT PËR
ZHVILLIM, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 10473, DATË 27.10.2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për konvertimin e borxhit për zhvillim, ratifikuar me ligjin nr. 10473, datë 27.10.2011, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe



Ambasada e Italisë
Tiranë

Tiranë, më 21.11.2018
Nr. prot. 004828

NOTE VERBALE

Ambasada e Italisë në Tiranë i paraqet nderimet e saj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe duke iu referuar komunikimit të ministrit nr. 9415, të datës 14 maj 2018, me të cilën kjo Ambasadë është informuar për miratimin nga ana e ministrit të propozimit të Njesisë së Mbështetjes Teknike nr. 53 prot., datë 28 mars 2018, për të shtyrë kohëzgjatjen e Marrëveshjes Dypalëshe për Konvertimin e Borxhit përtej datës së skadencës 31 tetor 2018, shpreh pëlqimin e vet të plotë për ta bërë efektive zgjatjen e marrëveshjes në fjalë deri më 31 dhjetor 2019, për të bërë të mundur mbylljen e aktivitetit të projekteve të nisura.

Ambasada e Italisë në Tiranë përfiton nga rasti për t'i përsëritur Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, ndjenjat e vlerësimit dhe konsideratës së saj më të lartë.

(firma, vula)

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
e Republikës së Shqipërisë
TIRANË


Ambasciata d'Italia
Tirana

Tirana, 21 NOV. 2018
N° Prot. 004828

NOTA VERBALE

L'Ambasciata d'Italia a Tirana presenta i suoi complimenti al Ministero delle Finanze e dell'Economia della Repubblica d'Albania e con riferimento alla comunicazione del Ministro N. 9415 del 14 maggio 2018, con la quale questa Ambasciata è stata informata della approvazione da parte del Ministro della proposta della Unità di Supporto Tecnico prot. 53 del 28 Marzo 2018 di estendere la durata dell'Accordo Bilaterale per la Conversione del Debito oltre la data di scadenza del 31 ottobre 2018, esprime il suo pieno consenso a rendere effettiva la proroga dell'Accordo in oggetto fino al 31 dicembre 2019, al fine di consentire la conclusione delle attività dei progetti avviati.

L'Ambasciata d'Italia a Tirana si avvale dell'occasione per rinnovare al Ministero delle Finanze e dell'Economia della Repubblica di Albania i sensi della sua più alta stima e considerazione.



Ministero delle Finanze e dell'Economia
della Repubblica d'Albania
TIRANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 9521/8 Prot.

Tiranë, më 28/0.2019

Lënda: Mbi marrëveshjen dypalëshe për konvertimin e borxhit

AMBASADËS SË ITALISË NË TIRANË
Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr.2, 1010, Tiranë

I nderuar zoti Ambasador,

Lidhur me zgjatjen e afatit të "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Konvertimin e Borxhit, nënshkruar më 24 gusht 2011", kam nderin t'i referohem notës suaj verbale nr. 004828, datë 21.11.2018, e cila citon:

Ambasada e Italisë në Tiranë i paraqet nderimet e saj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe duke ju referuar komunikimit të Ministrit N. 9415 të datës 14 maj 2018, me të cilën kjo Ambasadë është informuar për aprovimin nga ana e Ministrit të propozimit të Njësisë së Mbështetjes Teknike prot. 53 të datës 20 Mars 2018 për të shtyrë kohëzgjatjen e Marrëveshjes Dypalëshe për Konvertimin e Borxhit përtej datës së skadencës të 31 tetorit 2018, shpreh konsensusin e vet të plotë për ta bërë efektive zgjatjen e Marrëveshjes në objekt deri më 31 dhjetor 2019, për të bërë të mundur mbylljen e aktivitetit të projekteve të nisura. Ambasada e Italisë në Tiranë përfiton nga rasti për ti përsëritur Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë ndjenjat e vlerësimit dhe konsideratës së saj më të lartë.

I nderuar zoti Ambasador,

Kam nderin t'ju konfirmoj në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për sa është propozuar nga Ambasada italiane në Tiranë dhe bie dakord që nota e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo letër e përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese të "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Konvertimin e Borxhit, nënshkruar më 24 gusht 2011".

Kjo marrëveshje ndryshuese do të hyjë në fuqi sipas parashikimeve të nenit 7) pika 7.1) të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Konvertimin e Borxhit, nënshkruar më 24.8.2011.

Gjithashtu ju informojmë se kjo shkresë zëvendëson shkresën tonë nr. prot 9921/2, datë 19.7.2019

Pranoni zoti Ambasador sigurimet e konsideratës më të lartë,

Me respekt,


MINISTËR
Anila Denaj



VENDIM

Nr. 792, datë 11.12.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “PËR NDËRTIMIN E
VENDPREHJEVE TË USHTARAKËVE
GREKË TË RËNË GJATË LUFTËS
GREKO-ITALIANE TË VITEVE 1940–
1941” DHE PËR MIRATIMIN E
NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA
KATEGORIA E RESURSIT “TOKË
BUJQËSORE” NË TOKË URBANE
“TRUALL/VARREZA”, TË PASURIVE
ME NR. 364/20 DHE NR. 364/21, ZONA
KADASTRALE 2131, NË KËLCYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10256, datë 25.3.2010, “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 742, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë Luftës Greko-Italiane të viteve 1940–1941”, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë Luftës Greko-Italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “arë”, me vlerë 448 000 (katërqind e dyzet e tetë mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 448 000 (katërqind e dyzet e tetë mijë) lekësh dhe shpenzimet procedurale, në vlerën 59 000 (pesëdhjetë e nëntë mijë) lekë do të përballohen nga Ministria e Mbrojtjes.

5. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Pronari, sipas të dhënave të tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur pranë Ministrisë së Mbrojtjes certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit.

7. Ministria e Mbrojtjes të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

8. Afatet për kryerjen e punimeve të jenë në përputhje me parashikimet e projektit “Mirëmbajtja, rinovimi dhe zgjerimi i varrezave të grekëve të rënë në luftën e viteve 1940–1941 në Këlcyrë, Shqipëri”.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas



planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të shtetit.

10. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në tokë urbane “truall/varreza”, të pasurive me nr. 364/20 dhe nr.364/21, zona kadastrale 2131, në Këlcyrë, sipas të dhënave në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Qarku Gjirokastrë, të pasqyrojë ndryshimin e kategorisë së resursit në dokumentacionin kadastral për pasuritë, sipas të dhënave në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara,

deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

13. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, qarku Gjirokastrë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



TABELA E SHPRONËSIMIT TË PRONARIT, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “PËR NDËRTIMIN E VENDPREHJEVE TË USHTARAKËVE GREKË, TË RËNË GJATË LUFTËS GREKO-ITALIANE TË VITEVE 1940-1941”

Nr.	Emër Mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale arë (m ²)	Sip. arë e prekur (m ²)	Çmimi arë (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. totale e ndërtesës me certifikatë (m ²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Shoqëria “Treleshina” sh.p.k. (aktualisht Bevcom sh.p.k.)	Këlcyrë, Përmet	arë	2131	364/20	5000	1845	112	206,640				206,640	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, më datë 14.5.2019
2	Shoqëria “Treleshina” sh.p.k. (aktualisht Bevcom sh.p.k.)	Këlcyrë, Përmet	arë	2131	364/21	5000	2155	112	241,360				241,360	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, më datë 14.5.2019
Vlera e shpronësimit							4000	112	448,000		-	-	448,000	

**VENDIM****Nr. 793, datë 11.12.2019**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 1148, DATË
25.11.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN,
PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR ‘RRUGA
HYRËSE FIER’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1148, datë 25.11.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) tabelave bashkëlidhur vendimit i shtohet edhe tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

b) në pikën 3, për pasuritë e llojit tokë “truell”, sipërfaqja 1 139.4 (një mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë katër) m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 13 672 800 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh, ndryshon dhe bëhet 1 158.8 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë pikë tetë) m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 13 914 485 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e katër-

mbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

c) pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 372 500 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen, përkatësisht:

- 322 500 (treqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) lekë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”;

ç) pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 13 914 485 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e katërmbydhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga:

- llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë, shuma 9 488 400 (nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë;

- buxheti i vitit 2015, zëri “Detyrime të prapambetura”, shuma 4 184 400 (katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë;

- buxheti i vitit 2019, zëri “Shpronësime”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”, shuma 241 685 (dyqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, si dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIN RRUGOR
“RRUGA HYRËSE FIER” (Shtesa)**

	Pronaret			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË													Vlera totale (lekë)	Adresa	Shënime
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë “arë”			Shpronësim tokë “truall”			Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jobanimi		Vl. kult. bujq. dru-frut. (lekë)				
								Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip.ndërt. konf. ZVRPP (m²)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas zvrpp (l/m²)	Vlera (lekë)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP-ja (m²)	Vlera sipas preventivit (lekë)					
1	Kozma	Naun	Kulari	8532	3/446	Truall	440.3				9.7	12458								120,842.60	Sheq i madh, rr. “Teodor Muzaka”, banesa nr. 93, përballë DPQRR-së	Konf. nga ZVRPP-ja	
2	Kristaq	Naun	Kulari	8532	3/449	Truall	440.3				9.7	12458								120,842.60	Sheq i madh, rr. “Teodor Muzaka”, banesa nr. 93, përballë DPQRR-së	Konf. nga ZVRPP-ja	
	SHUMA										19.4									241685.2			

**VENDIM****Nr. 794, datë 11.12.2019**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR
“RRUGA E ARBRIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga e Arbrit”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “arë” dhe tokë “truall”, me vlerë 1 768 919 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 768 919 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh do të përballohet nga buxheti i vitit 2019, zëri “Shpronësime”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në Autoritetin Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURIT PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTT
“NDËRTIMI I SEGMENTTT RRUGOR ‘RRUGA E ARBRIT’”

Çmimi për pasurinë e llojit “tokë arë” dhe “truall” janë sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016

N/R	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË						VLERA TOTALE (Lekë)	RRETHI	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pasurisë	Lloji. Pasurisë	Sip. Totale (m2)	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"					
								Sip.e prekur (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera në (lekë)						
1	LAVDRIM MIRVETE	RAMADAN TAHIR	JOLLA	2592	759/1	ARE	1770	138.6	115	15,939.00				15,939.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
2	BP. NURÇE			2592	759/2	ARE+TRUALL+ NDERTESE	2102	446	115	51,290.00				51,290.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
3	MUSTAFA	VEHAP	SHEHU	2592	552/1	ARE	14085	529	115	60,835.00				60,835.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
4	HAJRI	VEHAP	SHEHU	2592	552/2	ARE	14142	637	115	73,255.00				73,255.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
5	HAJRI	VEHAP	SHEHU	2592	552/3	ARE	2006	103	115	11,845.00				11,845.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
6	HAXHI	SHABAN	TOMJA	2592	547/1	ARE	312	160	115	18,400.00				18,400.00	DIBËR	Konf. ZVRPP. Kufizime ne Seksionin E te Karteles se Pasurise.
7	HYSNIJE LUAN	DALHAZIS	GJONI	2592	547/3	ARE	270	128	115	14,720.00				14,720.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
8	XHAMIA			2592	541	ARE	3007	363	115	41,745.00				41,745.00	DIBËR	Konf. ZVRPP. Kufizime ne Seksionin E te Karteles se Pasurise.
9	HASHIM	XHETAN	KESHI	2592	540/5	TRUALL + NDERTESE	2500				488	140	68,320.00	68,320.00	DIBËR	Konf. ZVRPP. Kufizime ne Seksionin E te Karteles se Pasurise.
10	BP MUÇA			2592	591/7	ARE	1550	313	115	35,995.00				35,995.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
11	BARDHYL	MEHMET	GJONI	2592	591/3	ARE	1040	468	115	53,820.00				53,820.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
12	BP GJONI			2592	598	ARE	3800	313	115	35,995.00				35,995.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
13	PRONAR I PA VERTETUAR			2592	682/1	TRUALL+ NDERTESE	240				24	140	3,360.00	3,360.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
14	DYLBER	ISUF	KOSIQI	2592	682	ARE	4127	243	115	27,945.00				27,945.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
15	BP SHITREZI			2592	681	ARE	2980	226	115	25,990.00				25,990.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
16	BP ABAZI			2592	676	ARE	5849	1108	115	127,420.00				127,420.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
17	ILJAZ	OSMAN	MUÇA	1224	1/1	ARE	2500	359	115	41,285.00				41,285.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
18	SHABAN	DALIP	MUÇA	1224	1/2	ARE	1250	254	115	29,210.00				29,210.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
19	BP MUÇA			1224	1/3	ARE	1250	188	115	21,620.00				21,620.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
20	RASIM	DILAVER	VELIU	1224	2/2	ARE	1760	34	115	3,910.00				3,910.00	DIBËR	Konf. ZVRPP. Kufizime ne Seksionin E te Karteles se Pasurise.
21	SADULLA	DILAVER	VELIU	1224	2	ARE	1766	610	115	70,150.00				70,150.00	DIBËR	Konf. ZVRPP



22	LAVDI	SALI	HASA	1224	3/1	ARE	2375	22	115	2,530.00				2,530.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
23	XHEJLIL	SALI	HASA	1224	3	ARE	2375	409	115	47,035.00				47,035.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
24	RIFAT	QAMIL	HASA	1224	24	ARE	3000	459	115	52,785.00				52,785.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
25	MEHMET	QAMIL	HASA	1224	28	ARE	3000	348	115	40,020.00				40,020.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
26	LUTFI	ZENEL	TROCA	1224	29	ARE	4500	286	115	32,890.00				32,890.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
27	ILAZ	OSMAN	MUÇA	1224	30/1	ARE	2250	132	115	15,180.00				15,180.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
28	SHABAN	DALIP	MUÇA	1224	30/2	ARE	1125	151	115	17,365.00				17,365.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
29	BP MUÇA, etj			1224	30/3	ARE	1125	153	115	17,595.00				17,595.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
30	ILIAZ	OSMAN	MUÇA	1224	31	ARE	5150	807	115	92,805.00				92,805.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
31	MEHMET	LIMAN	TURJA	1224	22	ARE	2375	107	115	12,305.00				12,305.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
32	SADULLA	DILAVER	VELJU	1224	23	ARE	3620	161	115	18,515.00				18,515.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
33	DESTAN	HAZIZ	MUÇA	1225	1/1	ARE	3100	376	115	43,240.00				43,240.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
34	RAMAZAN	MUSLI	ÇALLAKU	1225	2/1	ARE	2000	65	115	7,475.00				7,475.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
35	RINO	RUSTEM	DEDA	1225	2/2	ARE	2000	77	115	8,855.00				8,855.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
36	RAZI	PETRIT	KALLÇISHTA	1225	2/3	ARE	2000	128	115	14,720.00				14,720.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
37	HAJRI	HASAN	CAPA	1225	3/1	ARE	3108	80	115	9,200.00				9,200.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
38	TONI	NAZIF	KALLÇISHTA	1225	3/3	ARE	5842	298	115	34,270.00				34,270.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
39	HAJRI	HASAN	CAPA	1225	3/4	ARE	1800	23	115	2,645.00				2,645.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
40	RRUZHDI	RAMADAN	MUÇA	1225	18	ARE	2200	494	115	56,810.00				56,810.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
41	IYZI	RAMADAN	MUÇA	1225	26	ARE	2000	931	115	107,065.00				107,065.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
42	IYZI	RAMADAN	MUÇA	1225	21	ARE	600	15	115	1,725.00				1,725.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
43	XHEVIT	HALIT	MUÇA	1225	22	ARE	532	55	115	6,325.00				6,325.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
44	MUZAFER	HAKI	MUÇA	1225	24	ARE	480	121	115	13,915.00				13,915.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
45	SINAN	SABEDIN	MUÇA	1225	25	ARE	560	124	115	14,260.00				14,260.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
46	RIZA	HALIT	MUÇA	1225	147	ARE	1280	697	115	80,155.00				80,155.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
47	XHEVIT	HALIT	MUÇA	1225	146	ARE	1512	1512	115	173,880.00				173,880.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
48	RIZA	HALIT	MUÇA	1225	23	ARE	504	107	115	12,305.00				12,305.00	DIBËR	Konf. ZVRPP
S H U M A								14758.6		1,697,239.00	512		71,680.00	1,768,919.00		

**VENDIM****Nr. 796, datë 11.12.2019**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Pika 1/1, e nenit 24, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1/1. Autoriteti vendor vendos, me procedurë të përshpejtuar, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e paraqitjes së aplikimit në sistemin *e-lege*, për pajisjen me leje ndërtimi, për ndërtimin, riparimin apo restaurimin e objekteve të dëmtuara, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.

Përfundimisht, vetëm për këto raste, autoriteti përgjegjës për miratimin e lejeve të ndërtimit për ndërtimin, riparimin apo restaurimin e objekteve të dëmtuara, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, është kryetari i bashkisë brenda territorit administrativ të bashkisë ku kërkohet leja me procedurë të përshpejtuar, dhe:

a) aplikimet paraqiten për shqyrtim dhe miratim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve nga ana e Institutit të Ndërtimit, bashkisë përkatëse apo projektuesve të licencuar;

b) dokumentacioni i vetëm që duhet të dorëzohet nga aplikuesi është:

i. akti i konstatimit për objektin e dëmtuar, i hartuar nga strukturat përkatëse të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi;

ii. projekti teknik/konstruktiv i hartuar nga Instituti i Ndërtimit, bashkia përkatëse apo projektuesit e licencuar.”.

Neni 2**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****VENDIM****Nr. 799, datë 11.12.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 170, DATË 27.3.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
SHPËRNDARJEN DHE DETAJIMIN E
FONDIT 1 000 000 000 (NJË MILIARD)
LEKË NË PROGRAMIN ‘MENAXHIMI I
INFRASTRUKTURËS SË UJITJES
DHE KULLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 170, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, fondi 1 000 000 000 (një miliard) lekë zëvendësohet me 1 116 424 574 (një miliard e njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë;

b) Tabela 1, “Lista e projekteve”, ndryshohet sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shtesa e vlerës së financimit, prej 116 424 574 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh, për vitin 2019, e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga rishpërndarja e fondeve të



akorduara me aktin normativ nr. 2, datë 2.10.2019, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, për programin “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”, dhe diferencat e prokurimeve të këtij programi”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 800, datë 11.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 237, DATË 6.3.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR
HAPJEN DHE MBYLLJEN
E SPITALEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 237, datë 6.3.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Personat juridikë, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shërbimit spitalor jopublik, përveç kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në legjislacionin për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme të mëposhtme, si dhe kriteret e përcaktuara në shtojcat I, II e III, që i bashkëlidhen këtij vendimi.”.

2. Pas shtojcës II, shtohet shtojca III, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA III

I. PJESA E PËRGJITHSHME

1. Spitali ditor përfshin çdo ndërhyrje kirurgjikale apo procedurë invazive, diagnostikuese apo terapeutike të pacientëve nën anestezi të përgjithshme, lokale, apo sedacion, të cilët shtrohen dhe dalin nga spitali brenda së njëjtës ditë, sipas një plani shtrimi paraparak. Kjo formë e ndihmës arrihet nga mjeku specialist i kontraktuar me kohë të plotë ose të pjesshme.

2. Ndërtesa e spitalit ditor mund të jetë e përfshirë në ndërtesën e spitalit publik në një ose disa reparte të dedikuara të spitalit publik/jopublik, të dedikuar për spital ditor, mund të jetë e përfshirë në strukturën e një ndërtese të veçantë ose të jetë një ndërtesë e veçantë.

3. Spitali ditor ndahet në klasa, si më poshtë vijon:

a) Klasa A përfshin çdo procedurë mjekësore që përfshin administrimin e barnave anestetikë lokalë, spinalë, epiduralë, sedacionë ose të përgjithshëm;

b) Klasa B (kirurgjia ditore) përfshin çdo procedurë kirurgjikale të kryer nën sedacion, nën anestezi.

4. Në rast të çdo komplikacioni, spitali ditor merr masat e nevojshme për shërbimin e plotë dhe trajtimin optimal të pacientit, pa rrezikuar jetën apo shëndetin e tij dhe siguron referimin në një spital publik/jopublik, sipas një protokollit të lëvizjes së pacientëve drejt një strukture spitalore.

5. Lista e medikamenteve është e njëjtë me atë të përcaktuar në aneksin 2.1, të këtij vendimi.

6. Orari i punës së spitalit ditor:

Spitalet ditore ofrojnë ndihmën e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

II. KRITERE TË PËRGJITHSHME TË INFRASTRUKTURËS

1. Spitali ditor respekton normat urbanistike dhe të arkitekturës, sipas legjislacionit në fuqi, dhe siguron aksesueshmëri në mjediset e tyre për personat me aftësi të kufizuara, sipas standardeve të



miratuara në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

2. Spitali ditor siguron plotësimin e kushteve të mëposhtme:

a) Spitali ditor duhet të ketë sisteme sinjalizimi për hyrje-daljet, lëvizshmëri të lirë të stafit, pacientëve dhe vizitorëve në sektorët funksionalë;

b) Muret duhet të jenë rezistente ndaj larjes dhe dezinfektimit, me instalime elektrike të përshtatshme për larje dhe dezinfektim dhe me dysheme të qëndrueshme ndaj agjentëve kimikë dhe fizikë;

c) Sistemet teknologjike duhet t'i nënshtrohen mirëmbajtjes së zakonshme dhe të jashtëzakonshme, sipas përcaktimeve të prodhuesit, të rregullave teknike dhe të legjislacionit përkatës në fuqi për përdorimin e tyre;

ç) Duhet të ketë sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe materialet shpërthyes, si dhe kontratën paraprake me SHMKZ-në;

d) Duhet të ketë burim të furnizimit me rrymë elektrike të pandërprerë dhe sistem të pavarur ushqimi elektrik (gjenerator) për sigurimin e vazhdimësisë së rrymës elektrike;

dh) Duhet të plotësojë kushtet për kondicionimin dhe ventilimin e mjediseve spitalore me sistem qendror për të sëmurët e shtruar, jo të shtruar dhe të personelit spitalor;

e) Duhet të ketë ndriçim të përshtatshëm ngado nëpër spital;

ë) Duhet të ketë ndriçim artificial për të gjitha dhomat e pacientëve ose edhe burime të tjera të ndriçimit për orët e leximit të vetë pacientëve;

f) Duhet të ketë ujë të dedikuar për konsum njerëzor me ujë të rrjedhshëm, higjienikisht të pastër, nga rrjeti i furnizimit të pandërprerë, dhe rezerva ujore të mjaftueshme, në rast të ndërprerjes së furnizimit;

g) Duhet të ketë akt miratimi për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare, sipas legjislacionit në fuqi;

gj) Duhet të ketë akt miratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, kur ofrohet shërbim që emeton rrezatim jonizues ose jojonizues;

h) Duhet të ketë kontratë paraprake për menaxhimin e mbetjeve spitalore me një kompani të licencuar sipas legjislacionit në fuqi;

i) Duhet të ketë rregullore të posaçme për parandalimin e aksidenteve në punë dhe kushte

optimale të higjienës në punë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mjekësinë e punës.

3. Spitali ditor siguron këto kritere për mjediset e brendshme:

a) Të ketë njësinë e pranimit, ku kryhet regjistrimi i pacientëve/zona e sekretarisë dhe informacionit/arkivi i dokumentacionit shëndetësor;

b) Të ketë në mjediset e brendshme ambiente të dedikuara për shtrimin e pacientëve dhe për të siguruar lëvizshmëri të plotë të pacientëve jashtë dhomave të shtrimit, pas operacionit;

c) Të ketë në mjediset e brendshme dhe një hapësirë të organizuar pushimi/pritje për vizitorët dhe pacientët;

ç) Të ketë një ambient të posaçëm për ruajtjen e barnave për përdorim të spitalit ditor, duke plotësuar kushtet e ruajtjes së barnave sipas legjislacionit në fuqi;

d) Të ketë kutinë e ndihmës së shpejtë (*crash card*) për trajtimin e pacientëve që rrezikojnë ose bëjnë arrest kardiak, e cila përmban barna dhe pajisje mjekësore të nevojshme, si më poshtë:

i. monitorë/defibrilatorë, aspiratorë dhe Ambu;

ii. barna për suport kardiak, sipas protokolleve të urgjencës mjekësore;

iii. barnat e linjës së parë për trajtimin e problemeve të zakonshme, sipas protokolleve mjekësore përkatëse;

iv. barna dhe materiale mjekësore të domosdoshme për intubimin e shpejtë të pacientit;

v. barna të domosdoshme për qasje venoze periferike dhe qendrore.

dh) Të ketë marrëveshje paraprake me Bankën e Gjakut, sipas legjislacionit në fuqi;

e) Të ketë shërbim sterilizimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të siguruar nga vetë institucioni ose të kontraktuar.

4. Kriteret për teknologjinë mjekësore dhe pajisjet mjekësore:

a) Spitali ditor mban një inventar të pajisjeve mjekësore dhe disponon një program të kontrollit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm të tyre;

b) Spitali ditor siguron një funksionim të sigurt të pajisjeve mjekësore, në përputhje me rregullat teknike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

5. Kriteret për personelin shëndetësor:

a) Të gjitha rolet dhe pozicionet funksionale mbulohen nga personel i licencuar dhe i pajisur me



leje të ushtrimit të profesionit nga urdhri përkatës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për profesionet e rregulluara;

b) Personeli mjekësor duhet të përfshijë:

i. drejtuesin mjekësor;

ii. të paktën një mjek dhe një infermier për çdo njësi (specialitet) shërbimi mjekësor;

iii. stafin ndihmës, në raport me numrin e aktiviteteve mjekësore të ofruara për çdo shërbim (repart) të spitalit ditor.

6. Kriteret për dokumentacionin shëndetësor:

a) Spitali ditor disponon një kartelë mjekësore për çdo pacient, të firmosur nga mjeku kurues/diagnostikues, sipas tipit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë;

b) Kartela klinike ruhet në administratën e spitalit, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe dokumentacionin shëndetësor;

c) Spitali ditor disponon regjistër të veçantë për çdo repart/njësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat mjekësore të pacientit.

7. Kriteret për menaxhimin e informacionit:

a) Spitali menaxhon informacionin shëndetësor në mënyrë të tillë që lehtëson ndjekjen e ecurisë dhe vazhdimësinë e trajtimit shëndetësor e të privatësisë së pacientëve, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për kujdesin shëndetësor;

b) Të dhënat mjekësore të pacientit mbahen në mënyrë të saktë dhe të detajuara, në mënyrë të tillë që një profesionist tjetër shëndetësor të kujdeset për pacientin, me qëllimin e vazhdimësisë efektive të kujdesit për pacientin;

c) Ruajtja e të dhënave mjekësore duhet të jetë efektive, duke siguruar që:

i. të dhënat mjekësore të jenë lehtësisht të arritshme për personelin shëndetësor;

ii. të dhënat mjekësore të jenë ruajtur në mënyrë të sigurt, për të siguruar konfidencialitetin e pacientit dhe për ta mbrojtur nga personat e paautorizuar, që kanë qasje në ato shënime;

iii. ruajtja e të dhënave të arkivuara (duke përfshirë të dhënat elektronike) të bëhet sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale;

iv. të mbrohen nga zjarri, parazitë dhe pluhuri.

ç) Informacioni i pacientit lëshohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

d) Siguron sistemin e raportimit të incidenteve teknike dhe klinike pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

8. Kontrolli i infeksionit:

a) Kontrolli dhe parandalimi i infeksionit spitalor bëhet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për kontrollin dhe luftimin e sëmundjeve infektive;

b) Spitali ditor disponon një program të kontrollit të infeksionit spitalor;

c) Personi përgjegjës për kontrollin e infeksionit spitalor është pjesë përbërëse e stafit mjekësor të spitalit ditor dhe koordinon punën për zbatimin e programit të kontrollit e të parandalimit të infeksionit spitalor dhe të standardeve mjekësore;

ç) Spitali ditor disponon një kontratë të menaxhimit të mbetjeve spitalore me një nga kompanitë e licencuara për këtë shërbim.

III. KRITERE TË VEÇANTA SIPAS KLASAVE

A. Spitali ditor i klasës “A”:

1. Spitali ditor i klasës “A” përfshin çdo procedurë mjekësore që përfshin administrimin e një bari anestetik spinalë, epiduralë ose të përgjithshëm.

2. Njësitë funksionale të shtrimit në spitalin ditor të klasës “A” duhet të përfshijnë kriteret e mëposhtme:

a) Spitali ditor i klasës “A” ka një kapacitet jo më shumë se 15 shtretër;

b) Ka mjedis pranimi të dedikuar për shërbimet e sekretarisë, regjistrimit dhe arkivit;

c) Ka mjedis qëndrimi dhe pritjeje për pacientët dhe vizitorët;

ç) Ka mjedis për menaxhimin shëndetësor të pacientëve të shtruar, ku përfshihen dhomat e pacientëve ose poltronat, si dhe mjediset ku kryhet manipulimi i pacientëve;

d) Ka dhomë për personelin shëndetësor (mjek/infermier), ku përfshihen mjediset e posaçme të ndërrimit të veshjeve, veçmas për gratë dhe burrat;

dh) Ka mjedis të dedikuar për ruajtjen e barnave, të materialeve mjekësore dhe veshjeve të pastra;

e) Ka mjedis për grumbullimin dhe ruajtjen e mbetjeve spitalore;

ë) Ka shërbim diagnostikues imazherik;

f) Ka shërbim laboratorik për analiza kimike-klinike.



B. Spitali ditor i klasës “B” - (Kirurgjia ditore):

1. Spitali ditor i klasës “B” duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara për spitalin e klasës “A” dhe, specifikisht, edhe këto kriterë:

a) Kirurgjia ditore duhet të përfshijë shtrimin në spital të pacientit për jo më shumë se 24 orë;

b) Spitali ditor i klasës “B” duhet të ketë një kapacitet jo më shumë se 10 shtretër për çdo sallë operacioni;

c) Kirurgjia ditore duhet të përfshijë edhe disa shtrime të programuara të pacientit, të cilat kërkojnë disa ndërhyrje komplekse të disa specialiteteve mjekësore të karakterit diagnostik, terapeutik ose rehabilitues. Këto ndërhyrje nuk mund të kryhen në institucionet e kujdesit të shërbimit shëndetësor parësor dhe kërkojnë një mbikëqyrje të stafit mjekësor e infermieror brenda harkut ditor;

ç) Shërbimi në kirurgjinë ditore duhet të përfshijë:

i. egzaminimet dhe vizitat mjekësore përpara ndërhyrjes kirurgjikale;

ii. ndërhyrjen kirurgjikale;

ii. vizitat mjekësore pas ndërhyrjes kirurgjikale.

d) Kirurgjia ditore duhet të përfshijë karakteristikat e mëposhtme:

i. të jenë të programuara dhe të përzgjedhura;

ii. kohëzgjatja e ndërhyrjes kirurgjikale, sipas protokolleve mjekësore të miratuara, të jetë, mestarisht 2 orë;

iii. të ketë rrezik të ulët komplikacioni postoperator.

2. Kriteret për personelin mjekësor:

a) Kirurgjia ditore duhet të ketë:

i. stafin mjekësor dhe ndihmës në raport me numrin e aktiviteteve mjekësore të ofruara për çdo shërbim (repart) të spitalit ditor;

ii. rregulla të qarta për orët dhe mënyrën e punës së personelit, mjekë dhe infermierë të kontraktuar me kohë të plotë ose të pjesshme;

iii. mjekë kirurg të specializuar në degën e kërkuar, në përputhje me specialitetin përkatës, sipas aktivitetit që ofron spitali ditor, me licencë të njohur nga Urdhri i Mjekut të Shqipërisë;

iv. mjekë anesteziist, të pajisur me licencë të njohur nga Urdhri i Mjekut të Shqipërisë në anestezi/reanimacion;

v. infermierë me licencë të njohur nga Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për profesionet e rregulluara;

vi. të paktën një personel teknik për përdorimin e pajisjeve mjekësore;

vii. personel ndihmës/mbështetës.

b) Gjatë orëve kur spitali kryen ndërhyrje kirurgjikale, duhet të ketë:

i. praninë e, të paktën, një mjeku kirurg të specializuar në nënspecialitetin, sipas aktivitetit që kryen shërbimi i kirurgjisë ditore;

ii. praninë e, të paktën, një mjeku anesteziist;

iii. praninë e një kryeinfermieri ose, të paktën, dy infermierë;

iv. personel mjekësor në gatishmëri 24 orë.

c) Kriteret e infrastrukturës të shërbimit të kirurgjisë ditore kur spitali e ofron një shërbim të kirurgjisë invazive ose semi invazive

Kriteret e infrastrukturës për shërbimin e kësaj kirurgjie përfshijnë:

i. salla operatore/blloku operator;

ii. zona të vëzhgimit postoperator, me një, dy ose disa shtretër;

iii. dhoma të pacientëve me jo më shumë se katër shtretër, të pajisur me tualetin përkatës;

iv. dhomën e vizitës dhe të mjekimit.

ç) Kriteret e veçanta të ndërtimit të spitalit ditor të klasës “B”

Ndërtimi i spitalit ditor të klasës “B” duhet të plotësojë këto kriterë të veçanta:

i. dhomat me një shtrat, jo më të vogla se 12 (dymbëdhjetë) m²;

ii. dhomat me dy shtretër, jo më pak se 8 (tetë) m² për çdo shtrat pacienti;

iii. në dhomat e pacientëve, për çdo shtrat, duhet të ketë një pajisje qendrore oksigjeni dhe vakuumi të veçantë;

iv. ambienti i infermierisë duhet të jetë pranë dhomave të pacientëve, të jetë e pajisur me lavaman, me vend ku përgatitet mjekimi, si dhe me një sistem thirrës emergjence, që të bëhet lidhja me çdo dhomë të pacientëve;

v. duhet të ketë sallën e operacionit dhe një ambient zgjimi me, të paktën, 2 shtretër, dhe në kokën e krevatit të pacientit të jetë i pajisur me sistem monitorimi dhe sistem qendror të oksigjenit e vakuumit;

vi. në çdo sallë të operacionit duhet të ndodhet vetëm një shtrat operacioni;

vii. sallat e operacionit duhet të jenë 20 (njëzet)m², pa cepat dhe kolonat;

viii. në hapësirën e sallës së operacionit, në nivelin e krevatit operator, lartësia dysHEME-tavan



duhet të jetë, të paktën, 2.6 metra (dy metra e gjashtëdhjetë centimetra) dhe tavani i varur të jetë i përshtatshëm që të bëhen kanalet e ajrosjes e të vendosen filtrat;

ix. salla e operacionit të ketë sistem kondicionimi qendror (UTA) me filtra antibakterialë, me qarkullim fluksi laminar dhe presion pozitiv;

x. pjesët e korridorit të bllokut operator, në zonën ku transportohen pacientët, duhet të kenë, të paktën, një gjerësi prej 1.8 m (një metër e tetëdhjetë centimetra);

xi. blloku operator duhet të ketë vende complete dhe jocomplete sterile. Hapësira e sallës së operacionit, që duhet të jetë komplet sterile, të ketë dritaret dhe dyert që nuk hapen në ambientin e jashtëm dhe në këto pjesë nuk gjendet dhomë tualeti. Në ato pjesë të bllokut operator ku sterilizimi është jo i plotë, duhet të gjendet një vend pushimi për personelin, dhoma të ndara zhveshjeje dhe veshjeje, dhomë tualeti me dush, depo të materialeve të pastra;

xii. korridoret në repartin e shtrimit, ku lëvizin barelat, duhet të jenë të gjera jo më pak se 1.8 metra (një metër e tetëdhjetë centimetra);

xiii. për ato godina, që janë mbi një kat, është e detyrueshme që të ketë një dalje alternative emergjence;

xiv. dyshemetë dhe veshjet e dyshemeve duhet të jenë të mirërregulluara, të buta (lëmuara) dhe joabsorbuese;

xv. muret dhe tavanet e dhomave e të korridoreve të jenë të ndërtuara në mënyrë të tillë që mund të pastrohen lehtësisht dhe të mirëmbahen;

xvi. në katet nën tokë:

- muret dhe dyshemetë e vendosura nën nivelin e tokës duhet të jenë të papërshkueshme nga uji;

- platformat dhe muret, që përfshijnë pjesë të mureve të vendosura nën nivelin e tokës, duhet të jenë të mbrojtura nga kafshët helmuese;

- të gjitha dritaret dhe portat që hapen duhet të jenë të pajisura me një rrjetë kundër insekteve dhe kafshëve të tjera helmuese.

xvii. përveç dhomave të pajisura me tualet dhe lavaman, spitali duhet të parashikojë një vend praktik me, të paktën, një tualet me lavaman për:

- personelin e administratës;
- personelin mjekësor;
- vizitorët e të afërmit e pacientëve.

xviii. tualetet dhe lavamanët e parashikuara për burrat duhet të jenë të ndara nga ato të grave.

VENDIM

Nr. 801, datë 11.12.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT DHE TË PUNËMARRËSVE TË EKSPOZUAR PROFESIONALISHT NDAJ RREZATIMIT JONIZUES, DHE SIGURISË NDAJ EKSPOZIMEVE MJEKËSORE ME BURIMET E RREZATIMIT JONIZUES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për mbrojtjen e publikut dhe të punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues, dhe sigurisë ndaj ekspozimeve mjekësore me burimet e rrezatimit jonizues, sipas tekstit dhe shtojcave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave: nr. 481, datë 25.7.2012, “Për miratimin e rregullore “Për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese”, nr. 590, datë 18.8.2011, “Për miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese”, nr. 229, datë 20.3.2013, “Për miratimin e rregullore “Për sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues”, dhe nr. 543, datë 7.7.2010, “Për miratimin e rregullore “Për punë të sigurt me burimet e rrezatimeve jonizuese”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, të gjitha institucionet e tjera që janë përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e publikut nga rrezatimi jonizues, punëmarrësve, nxënësve apo praktikantëve ndaj ekspozimit profesional, si dhe



pacientëve ose mbështetësve të tyre ndaj ekspozimit mjekësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1.1.2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT DHE TË
PUNËMARRËSVE TË EKSPOZUAR
PROFESIONALISHT NDAJ RREZATIMIT
JONIZUES, DHE SIGURISË NDAJ
EKSPOZIMEVE MJEKËSORE ME
BURIMET E RREZATIMIT JONIZUES

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton kërkesat dhe rregullat për sigurinë e ekspozimit publik, profesional dhe mjekësor që vjen nga burimet e rrezatimit jonizues, të detyrueshme për të gjitha aktivitetet e përcaktuara me ligj.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet vetëm për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, i cili përfshin burime radioaktive të hapura ose të mbyllura dhe gjeneratorë me rreze X.

2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha situatat që përfshijnë ekspozimin ndaj rrezatimit që është për t'u kontrolluar. Ekspozimet që nuk konsiderohen si të përshtatshme për t'u kontrolluar, përjashtohen nga fushëveprimi i kësaj rregulloreje.

3. Kjo rregullore zbatohet për tri kategori të ekspozimit: ekspozimi profesional, ekspozimi publik dhe ekspozimi mjekësor.

4. Kjo rregullore përcakton kërkesat që do të plotësohen në të gjitha objektet dhe aktivitetet që sjellin rritje të riskut nga rrezatimet.

5. Kjo rregullore nuk mbulon masat e sigurimit.

6. Përjashtohen nga fusha e zbatimit të rregullores ekspozimet si më poshtë:

a) ekspozimet ndaj nivelit natyror të rrezatimit,

siç janë radionuklidet që përmban trupi i njeriut dhe rrezatimi kozmik që mbizotëron në nivelin e tokës;

b) ekspozimet e anëtarëve të publikut ose punëmarrësve të tjerë të ndryshëm, nga ekuipazhet e avionëve ose të hapësirës, ndaj rrezatimit kozmik në fluturim ose në hapësirë;

c) ekspozimet në terren ndaj radionuklideve të pranishme në koren e tokës të padëmtuar.

7. Kjo rregullore përcakton në shtojcën I se cilat praktika ose burime brenda praktikave do të përjashtohen nga disa ose të gjitha kërkesat e kësaj rregulloreje, përfshirë kërkesat për njoftim, ose autorizimin, duke përdorur si bazë për këtë përcaktim kriteret e përjashtimit të specifikuar në shtojcën I ose çdo praktikë e përjashtuar siç përcaktohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet në bazë të këtyre kriterëve. Përjashtimi nuk lejohet për praktikat që konsiderohen se nuk janë të justifikuara.

8. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet miraton se cilat burime, përfshirë materialet dhe objektet, brenda praktikave të njoftuara ose të autorizuar, mund të çlirohen nga kontrolli rregullator, duke përdorur si bazë për këtë aprovim kriteret për çlirimin e specifikuar në rregulloren nr. 638, datë 7.9.2016 “Për trajtimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë” ose çfarëdo niveli të çlirimit të specifikuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet në bazë të këtyre kriterëve. Me anë të këtij miratimi, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që burimet të cilat janë çliruar nga kontrolli rregullator nuk do të bëhen përsëri objekt në kërkesë për njoftim, ose licencim, nëse nuk specifikohet.

Neni 3

Përkufizimet

1. “aktivim” nënkupton një proces nëpërmjet të cilit një nuklid i qëndrueshëm transformohet në radionuklid, duke u rrezatuar me grimca ose fotone me energji të lartë materialin në të cilin gjendet;

2. “aktivitet” (A) është madhësia e zërthimit e një sasive të radionuklidit në një gjendje të dhënë të energjisë në një kohë të dhënë. Është koeficienti i dN ndaj dt, ku dN është vlera e numrit të zërthimeve bërthamore në intervalin e kohës dt:



$$A(t) = \frac{dN}{dt}$$

Njësia e aktivitetit është bekerel (Bq);

3. “anëtarë të publikut” nënkupton individët që mund të jenë subjekt i ekspozimit publik;

4. “aspekte praktike të procedurave radiologjike mjekësore” nënkupton kryerjen fizike të një ekspozimi mjekësor dhe të çdo aspekti mbështetës, duke përfshirë trajtimin dhe përdorimin e pajisjeve mjekësore radiologjike, vlerësimin e parametrave teknikë dhe fizikë (duke përfshirë dozat e rrezatimit), kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes, përgatitja dhe administrimi i radio-farmaceutikës, dhe përpunimi i imazhit;

5. “auditim klinik” nënkupton një ekzaminim sistematik ose rishikim të procedurave radiologjike mjekësore që kërkon të përmirësojë cilësinë dhe rezultatin e kujdesit të pacientit nëpërmjet rishikimit të strukturuar, ku praktikatat, procedurat dhe rezultatet radiologjike mjekësore shqyrtohen sipas standardeve të miratuara për procedurat më të mira radiologjike mjekësore, me modifikimin e praktikave, aty ku është e përshtatshme, dhe zbatimin e standardeve të reja nëse është e nevojshme;

6. “bekerel” (Bq) është emri i veçantë i njësies së aktivitetit. Një bekerel është e barabartë me një zbërthim bërthamor për sekondë;

7. “burim i konsumuar” nënkupton një burim të mbyllur i cili nuk përdoret më ose tentohet të përdoret për praktikën për të cilën është dhënë autorizimi, por vazhdon të kërkojë menaxhim të sigurt;

8. “burim i mbyllur me aktivitet të lartë” nënkupton një burim të mbyllur për të cilin aktiviteti i radionuklidit është e barabartë ose e tejkalon vlerën e aktivitetit përkatës të përcaktuar në Kodin e drejtimit të sigurisë dhe sigurimit të burimeve radioaktive të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike;

9. “burim i mbyllur” nënkupton një burim radioaktiv në të cilin materiali radioaktiv është mbyllur përgjithmonë në një kapsulë ose inkorporuar në një formë solide me objektin për të ndaluar në kushte normale të përdorimit çdo shpërndarje ose shpërhapje të substancave radioaktive;

10. “burim i rrezatimit natyror” nënkupton çdo burim rrezatimi jonizues me origjinë natyrale, tokësore ose kozmike;

11. “burim i rrezatimit” nënkupton një entitet që mund të shkaktojë ekspozim, të tilla si duke emetuar rrezatim jonizues ose duke lëshuar material radioaktiv;

12. “burim jetim” nënkupton një burim radioaktiv i cili as nuk është çliruar nga kontrolli rregullator, sepse nuk ka qenë kurrë nën kontrollin rregullator ose sepse është i braktisur, humbur, vjedhur.

13. “burim radioaktiv” nënkupton një burim rrezatimi që përfshin material radioaktiv për qëllimin e përdorimit të radioaktivitetit të tij;

14. “dëmtim i shëndetit” nënkupton zvogëlimin e gjatësisë dhe cilësinë e jetës që ndodh në një popullsi pas ekspozimit, duke përfshirë ato që lindin nga reaksionet e indeve, kanceret dhe çrregullimet gjenetike të rënda;

15. “dëmtim individual” nënkupton efektet dëmtuese klinike të vëzhgueshme në individë ose pasardhës të tyre, pamja e të cilave është e menjëhershme ose e vonuar, dhe kur është e mëvonshme, nënkupton probabilitet të lartë sesa një siguri të shfaqes;

16. “doza e absorbuar” (D) është energjia e absorbuar për njësi të masës

$$D = \frac{d\bar{\epsilon}}{dm}$$

Ku:

de - është energjia mesatare e dhënë nga rrezatimi jonizues në materie në një element vëllimi,

dm - është masa e materies në këtë element vëllimi.

Në këtë rregullore, doza e absorbuar tregon dozën mesatare mbi një ind ose një organ. Njësia për dozën e absorbuar është grej (Gy) ku një grej është i barabartë me një xhaul për kilogram (J/kg);

17. “doza efektive” (E) është shuma e dozave të ponderuara ekuivalente në të gjitha indet dhe organet e trupit nga ekspozimi i brendshëm dhe i jashtëm. Ai përcaktohet me shprehjen:

$$E = \sum_T w_T \sum_R w_R \cdot D_{T,R}$$



Ku:

DTR është doza e absorbuar e mbivendosur mbi indin ose organin T, për shkak të rrezatimit

Wr është faktori i ponderimit të rrezatimit dhe

Wt është faktori i ponderimit të indeve për organin T.

Vlerat për Wt dhe Wr janë sipas specifikimeve të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike. Njësia për dozën efektive është sievert (Sv);

18. “doza efektive e akumuluar” (E (τ)) është shuma e dozave ekuivalente HT (τ) për një kohë të caktuar të organit ose të indeve që rezultojnë nga një ekspozim, secila e shumëzuar me faktorin e duhur të ponderuar të indeve wT. Njësia për dozë efektive të kryer është sievert (Sv);

19. “doza ekuivalente e akumuluar” (HT (t)) është shuma në kohën (t) të vlerave të dozës ekuivalente në indet ose organin T që do të merret nga një individ si rezultat i ekspozimit.

20. “dozë ekuivalente” (HT) është doza e absorbuar, në indin ose organin T të ponderuar për llojin dhe cilësinë e rrezatimit R. Është dhënë nga:

$$H_{T,R} = W_R \times D_{T,R}$$

Ku:

D (t,r) është doza e absorbuar mesatarisht mbi indin ose organin T, për shkak të rrezatimit R,

Wr është faktori i ponderimit të rrezatimit.

Kur fusha e rrezatimit është e përbërë nga lloje dhe energji me vlera të ndryshme të Wr, doza e ekuivalente totale, HT, jepet nga:

$$H_T = \sum_R w_R \cdot D_{T,R}$$

Vlerat për Wr janë specifikuar sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike. Njësia për dozën ekuivalente është sievert (Sv);

21. “dozë shtrënguese” nënkupton një kufizim të vendosur si një nivel i sipërm për dozën e ardhshme individuale, e përdorur për të përcaktuar gamën e opsioneve të shqyrtuara në procesin e optimizimit për një burim rrezatimi të dhënë në një situatë ekspozimi;

22. “eksperti i fizikës mjekësore” nënkupton një individ ose, nëse parashikohet në legjislacionin kombëtar, një grup individësh, që kanë njohuri, trajnim dhe përvojë për të vepruar ose dhënë këshilla për çështjet që lidhen me fizikën e rrezatimit të aplikuar për ekspozimin mjekësor,

kompetenca e të cilëve në këtë aspekt njihet nga autoriteti kompetent;

23. “eksperti për mbrojtje nga rrezatimi” nënkupton një individ ose, nëse parashikohet në legjislacionin kombëtar, një grup individësh që kanë njohuri, trajnim dhe përvojë e nevojshme për të dhënë këshilla për mbrojtje nga rrezatimi për të siguruar mbrojtjen efektive të individëve dhe kompetenca në këtë drejtim njihet nga autoriteti kompetent;

24. “ekspozim aksidental” nënkupton ekspozimin e individëve, përveç punëmarrësve të emergjencës, si rezultat i një aksidenti;

25. “ekspozim i mundshëm” nënkupton ekspozimin që nuk pritet me siguri, por mund të rezultojë nga një ngjarje ose një sërë ngjarjesh me natyrë probabilistike, duke përfshirë gabimet e pajisjeve dhe gabimet njerëzore;

26. “ekspozim i panevojshëm” do të thotë ekspozimi mjekësor që është dukshëm i ndryshëm nga ekspozimi mjekësor për një qëllim të caktuar;

27. “ekspozim jomjekësor” nënkupton çdo ekspozim të qëllimshëm të njerëzve për qëllime imazherike, ku qëllimi kryesor i ekspozimit nuk është të sjellë përfitim shëndetësor për individin që është ekspozuar;

28. “ekspozim mjekësor” nënkupton ekspozimin e pacientëve ose individëve asimptomatikë si pjesë e diagnozës ose trajtimit të tyre mjekësor ose dentar dhe që synon të përfitojë shëndetin e tyre, si dhe ekspozimin e kryer nga kujdestarët dhe mbështetësit dhe nga vullnetarët në mjekësinë ose biomjekësinë kërkimore;

29. “ekspozim normal” nënkupton ekspozimin që pritet të ndodhë në kushte normale të veprimtarisë ose aktivitetit (duke përfshirë mirëmbajtjen, inspektimin, mbylljen), duke përfshirë incidente të vogla që mund të mbahen nën kontroll, gjatë operimit normal dhe dukurive operationale të parashikuara;

30. “ekspozim profesional” nënkupton ekspozimin e punëmarrësve, nxënësve, praktikantëve, të shkaktuara gjatë punës, në procesin mësimor ose trajnues të tyre;

31. “ekspozim publik” nënkupton ekspozimin e individëve, duke përfshirë ekspozimet profesionale ose mjekësore.

32. “ekspozim” nënkupton aktin e ekspozimit ose gjendjen e ekspozimit ndaj rrezatimit



jonizues të lëshuar nga jashtë trupit (ekspozimi i jashtëm) ose brenda trupit (ekspozimi i brendshëm);

33. “ekspozimi i emergjencës në punë” nënkupton ekspozimin e marrë në situatën e ekspozimit emergjent nga një punëmarrës emergjence;

34. “ekspozimi ndaj radonit” nënkupton ekspozimin ndaj radonit dhe pasardhësve të radonit;

35. “ekstremitet” nënkupton duart, parakrahët, krahët, këmbët dhe shputat;

36. “emergjencë radiologjike” nënkupton një situatë ose ngjarje jorutinë që përfshin një burim rrezatimi që kërkon veprim të menjëhershëm për të zbutur pasojat serioze negative për shëndetin dhe sigurinë njerëzore, cilësinë e jetës, pronën ose mjedisin ose një rrezik që mund të shkaktojë rritje të pasojave të tilla serioze negative;

37. “gjenerator i rrezatimit” nënkupton një pajisje të aftë për të gjeneruar rrezatim jonizues, të tillë si rrezet X, neutronet, elektronet ose grimcat e tjera të ngarkuara;

38. “instalim mjekësor radiologjik” nënkupton një objekt ku kryhen procedurat mjekësore radiologjike;

39. “kontenier” nënkupton një bashkësi elementësh që synojnë të garantojnë mbajtjen e një burimi të mbyllur, ku ajo nuk është pjesë përbërëse e burimit, por është e destinuar për të mbrojtur dhe siguruar burimin gjatë transportimit dhe trajtimit të tij;

40. “kontroll rregullator” nënkupton çdo formë kontrolli ose rregullimi që zbatohet për aktivitetet njerëzore për zbatimin e kërkesave dhe sanksioneve për mbrojtjen nga rrezatimi;

41. “kontrolli i cilësisë ose kontrolli teknik” nënkupton grupin e veprimeve (programim, koordinim, implementim) që synon të ruajë ose të përmirësojë cilësinë. Ai përfshin monitorimin, vlerësimin dhe mirëmbajtjen në nivelet e kërkuara të të gjitha karakteristikave të performancës së pajisjeve që mund të përcaktohen, maten dhe kontrollohen;

42. “kufiri i dozës” nënkupton vlerën e dozës efektive (ku është e zbatueshme), dozën efektive të akumuluar ose dozën ekuivalente në një periudhë të caktuar të cilat nuk do të tejkalohen për një individ;

43. “kujdestarë dhe mbështetës” nënkuptojnë

individët që me vetëdije dhe vullnet të ekspozohen ndaj rrezatimit jonizues duke ndihmuar, përveçse si pjesë e profesionit të tyre, në mbështetjen dhe komoditetin e individëve që i nënshtrohen ose i janë nënshtruar ekspozimit mjekësor;

44. “magazini” nënkupton mbajtjen e materialit radioaktiv, një burim radioaktiv ose mbetje radioaktive, në një objekt me mundësinë e rikthimit për aktivitet të mëtejshëm;

45. “masa përmirësuese” nënkupton heqjen e burimit të rrezatimit ose zvogëlimin e aktivitetit ose masës së tij ose ndërprerjen e rrugëve të ekspozimit ose reduktimin e ndikimit të tyre me qëllim shmangien ose reduktimin e dozave që përndryshe mund të merren në një situatë ekspozimi ekzistuese;

46. “masat mbrojtëse” nënkupton masa, përveç masave përmirësuese, me qëllim shmangien ose reduktimin e dozave që mund të merren në raste të jashtëzakonshme të ekspozimit ose në një situatë ekspozimi ekzistuese;

47. “material radioaktiv” nënkupton materialin që përfshin gjendjet radioaktive;

48. “mbetje radioaktive” nënkupton material radioaktiv në formë të gaztë, të lëngët ose të ngurtë për të cilën nuk është parashikuar ose konsideruar përdorim i mëtejshëm nga një person juridik ose fizik e pranuar si e tillë, e cila është e rregulluar si mbetje radioaktive nga një autoritet rregullator kompetent sipas kuadrit legjislativ dhe rregullator;

49. “monitorim i substancave radioaktive në mjedis” nënkupton matjen e normave të dozës së jashtme për shkak të substancave radioaktive në mjedis ose të përqendrimit të radionuklideve në mjedis;

50. “ndërfutje” nënkupton aktivitetin e përgjithshëm të një radionuklidi që hyn në trup nga mjedisi i jashtëm;

51. “ndotje radioaktive” nënkupton praninë e padëshiruar ose të padëshirueshme të substancave radioaktive në sipërfaqe ose brenda lëndëve të ngurta, lëngjeve, gazeve ose në trupin e njeriut;

52. “nivel referimi diagnostik” nënkupton nivelet e dozës në praktikat radiologjike ose intervenuese radiologjike, ose në rastin e radiofarmaceutikëve nivelet e aktivitetit, për ekzaminimet tipike për grupet e pacientëve me madhësi standard ose fantoma standarde për llojet e pajisjeve me përdorim të gjerë.



53. “nivelet e çlirimit” nënkupton vlerat e përcaktuara nga autoriteti kompetent ose nga legjislacioni kombëtar dhe e shprehur në përqendrimet e aktivitetit, në ose nën këto vlera materialet dalin nga çdo praktikë që i nënshtrohet autorizimit dhe mund të hiqen nga kërkesat e kësaj rregulloreje;

54. “niveli i përjashtimit” nënkupton një vlerë të përcaktuar nga autoriteti kompetent ose nga legjislacioni dhe shprehur në formën përqendrim të aktivitetit ose aktivitetin total në ose nën të cilin burimi i rrezatimit nuk i nënshtrohet njoftimit ose autorizimit;

55. “niveli i referencës” nënkupton situatën e ekspozimit emergjent ose situatën ekzistuese të ekspozimit, nivelin e dozës efektive ose dozën ekuivalente ose koncentrimin e aktivitetit mbi të cilin është gjykuar si e papërshtatshme të lejojë të ndodhin ekspozimet si rezultat i situatës së ekspozimit, edhe pse nuk është një kufi që nuk mund të tejkalohet;

56. “përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimi” nënkupton një individ i cili është teknikisht kompetent në çështjet e mbrojtjes nga rrezatimi që lidhen me një lloj të caktuar të praktikës për të mbikëqyrur ose kryer zbatimin e masave për mbrojtjen nga rrezatimet;

57. “përgjegjësi klinikë” nënkupton përgjegjësinë e një praktikanti për ekspozimet individuale mjekësore, në veçanti justifikimin; optimizimin; vlerësimin klinik të rezultatit; bashkëpunimin me specialistë dhe stafin tjetër në lidhje me aspektet praktike të procedurave radiologjike mjekësore, marrjen e informacionit nëse është e përshtatshme nga ekzaminimet e mëparshme, sigurimin e informacionit ekzistues mjekësor radiologjik, të dhënave për praktikuesit e tjerë dhe/ose referuesit, sipas nevojës, dhe dhënien e informacionit mbi rrezikun e rrezatimit jonizues për pacientët dhe personat e tjerë të përfshirë;

58. “Përrshpejtues linear” nënkupton pajisjet ose instalimet në të cilat grimcat janë përrshpejtuar, duke emetuar rrezatim jonizues me energji më të madhe se 1 megaelektron volt (MeV);

59. “plani i reagimit emergjent” nënkupton aranzhimet për të planifikuar një përgjigje adekuate në rast të situatës së ekspozimit emergjent në bazë të ngjarjeve të parashikuara dhe skenarëve të lidhur;

60. “praktikant” nënkupton një person që merr trajnim ose udhëzim brenda një subjekti, me qëllim të ushtrimit të një aftësie të veçantë;

61. “praktikë” nënkupton një aktivitet njerëzor që mund të rrisë ekspozimin e individëve ndaj rrezatimit nga burimi i rrezatimit dhe menaxhohet si një situatë e ekspozimit të planifikuar;

62. “praktikues” do të thotë një mjek, dentist ose profesionist tjetër shëndetësor i cili ka të drejtë të marrë përgjegjësinë klinike për një ekspozim mjekësor individual në përputhje me kërkesat kombëtare;

63. “procedurë radiologjike mjekësore” nënkupton çdo procedurë që shkakton ekspozim mjekësor;

64. “produkt i konsumit” nënkupton një pajisje ose artikull të prodhuar në të cilin një ose më shumë radionuklide janë përfshirë qëllimisht, ose janë prodhuar me anë të aktivimit, ose që prodhojnë rrezatim jonizues dhe të cilat mund të shiten ose të vihen në dispozicion të anëtarëve të publikut pa një mbikëqyrje të veçantë ose kontrolli rregullator pas shites;

65. “punëmarrës i ekspozuar” nënkupton një person, qoftë i vetëpunësuar, ose që punon nën një punëdhënë, i cili është subjekt i ekspozimit në punë që kryhet në një praktikë të rregulluar me këtë rregullore dhe i cili është i detyruar të marrë doza që kalojnë një ose më shumë nga kufijtë e dozës për ekspozimin e publikut;

66. “punëmarrës i emergjencës” do të thotë çdo person që ka një rol të efektshëm në rast emergjence dhe i cili mund të jetë i ekspozuar ndaj rrezatimit në përgjigje të emergjencës;

67. “punëmarrës i jashtëm” do të thotë çdo punëmarrës i ekspozuar i cili nuk është i punësuar nga subjekti përgjegjës për zonat e mbikëqyrura dhe të kontrolluara, por kryen veprimtari në ato zona, i përfshirë me kontratë dhe studentët që punojnë në ato zona;

68. “radiodiagnostikë” ka të bëjnë me mjekësinë bërthamore diagnostike *in vivo*, radiologjinë diagnostike mjekësore duke përdorur rrezatimin jonizues dhe radiologjinë dentare;

69. “radiolog” janë personat që kanë të bëjnë me procedurat radiodiagnostike dhe radioterapeutike, dhe radiologjinë intervenuese ose përdorimet e tjera mjekësore të rrezatimit jonizues për qëllime të planifikimit, udhëheqjes dhe verifikimit;



70. “radiologji intervenuese” nënkupton përdorimin e teknikave të imazhit me rreze X për të lehtësuar futjen dhe drejtimin e pajisjeve në trup për qëllime diagnostikimi ose trajtimi;

71. “radioterapia” ka të bëjë me terapinë me rrezatim, duke përfshirë dhe mjekësinë bërthamore për qëllime terapeutike;

72. “radon” nënkupton radionuklidin ^{222}Rn dhe pasardhësit e tij;

73. “regjistrim” nënkupton lejen e dhënë në një dokument nga autoriteti kompetent, ose i dhënë nga legjislati kombëtar, nëpërmjet një procedure të thjeshtuar, për të kryer një praktikë në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislatin kombëtar ose të përcaktuara nga një autoritet kompetent për llojin ose praktikën;

74. “rrezatimi jonizues” nënkupton energjinë e transferuar në formën e grimcave ose valëve elektromagnetike me një gjatësi vale prej 100 nanometër ose më pak (një frekuencë prej 3×10^{15} hertz ose më shumë) të aftë për të prodhuar jonet direkt ose indirekt;

75. “shërbim dozimetrie” nënkupton një trupë, ose një individ të aftë për të kalibruar, lexuar ose interpretuar pajisjet individuale të monitorimit, ose për të matur radioaktivitetin në trupin e njeriut ose në mostrat biologjike, ose për të vlerësuar doza, kapaciteti i të cilave në këtë drejtim të jetë i njohur nga autoriteti kompetent;

76. “kontroll shëndetësor në punë” nënkupton një profesionist shëndetësor ose organ kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes mjekësore të punëtorëve të ekspozuar dhe aftësia e të cilëve për të vepruar në këtë aspekt njihet nga organi kompetent;

1. Ofruesit e produkteve të konsumit sigurojnë që produktet e konsumit të mos jenë në dispozicion të publikut, përveç nëse përdorimi i tyre nga anëtarët e publikut ka qenë i justifikuar, dhe përdorimi i tyre është përjashtuar, ose furnizimi i tyre për publikun është i autorizuar.

2. Ofruesit e produkteve të konsumit sigurojnë që produktet e konsumit të mos jenë në dispozicion të publikut, përveç nëse arsyetimi i përdorimit të tyre nga anëtarët e publikut është aprovuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, ose përdorimi i tyre është përjashtuar nga baza e kriterëve të legjislationit në fuqi, ose ofrimi i tyre për publikun është autorizuar.

3. Pas marrjes së një kërkesë për autorizim për të ofruar produkte të konsumit për publikun, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet:

a) kërkon nga ofruesi i produktit të konsumit të sigurojë dokumente për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat;

b) verifikon vlerësimet dhe zgjedhjen e parametrave të paraqitur në kërkesën për autorizim;

c) përcakton nëse përdorimi përfundimtar i produktit të konsumit mund të përjashtohet;

ç) autorizon dispozitën për publikun e produktit të konsumit, kur është e përshtatshme, duke iu nënshtruar kushteve specifike të autorizimit.

4. Ofruesi i produkteve të konsumit:

a) do të respektojë kushtet e autorizimit për të ofruar produkte të konsumit për publikun;

b) siguron që produktet e konsumit të respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje;

c) do të planifikojë për masat e duhura për servisin, mirëmbajtjen, riciklimin ose asgjësimin e produkteve të konsumit.

5. Dizajni dhe prodhimi i produkteve të konsumit, në rastet që mund të ndikojnë në ekspozimin gjatë trajtimit normal, transportit dhe përdorimit, si dhe në rast të sjelljes së keqpërdorimit, aksidenteve ose asgjësimit, do t'i nënshtrohen optimizmit të mbrojtjes dhe sigurisë. Në këtë drejtim, projektuesit, prodhuesit dhe ofruesit e tjerë të produkteve të konsumit do të marrin parasysh:



a) radionuklidet e ndryshme që mund të përdoren në produktet e konsumit dhe llojet e rrezatimit të tyre, energjitë, aktivitetin dhe zbërthimin;

b) format kimike dhe fizike të radionuklideve që mund të përdoren në produktet e konsumit dhe rëndësinë e tyre për mbrojtje dhe siguri në kushte normale dhe kushte jonormale;

c) kontrollin, mbrojtjen e substancave radioaktive në produktet e konsumit si dhe aksesin në to në kushte normale dhe kushte jonormale;

ç) nevojën për servis, ose riparim të produkteve të konsumit dhe mënyrat me të cilat mund të realizohen këto;

d) përvojën përkatëse me produkte të ngjashme të konsumit;

6. Ofruesit e produkteve të konsumit sigurojnë që:

a) kur është e mundur, një etiketë e lexueshme është e vendosur në një sipërfaqe të dukshme të secilit produkt të konsumit që:

i. tregon se produkti i konsumit përmban substanca radioaktive dhe identifikon radionuklidet dhe aktivitetet e tyre;

ii. produkti i konsumit për publikun është autorizuar nga trupa rregullatore;

iii. siguron informacione mbi opsionet e kërkuara ose të rekomanduara për riciklimin ose asgjësimin.

b) informacioni i specifikuar në pikën (a) më lart është i vlefshëm dhe për paketimin me pakicë të produktit të konsumit.

7. Ofruesit e produkteve të konsumit japin informacion dhe udhëzime të qarta dhe të përshtatshme për secilin produkt të konsumit në lidhje me:

a) instalimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e produktit të konsumit;

b) servisin dhe riparimin;

c) radionuklidet dhe aktivitetet e tyre në një datë të caktuar;

ç) shkallën e dozës në funksionimin normal dhe gjatë servisit dhe riparimit;

d) mundësitë e kërkuara ose të rekomanduara për riciklimin ose asgjësimin.

8. Ofruesit e produkteve të konsumit u sigurojnë shitësve me pakicë të produkteve të konsumit informacionin e duhur për sigurinë si dhe udhëzimet për transportin dhe ruajtjen e tyre.

V. SITUATAT E PLANIFIKUARA TË EKSPOZIMEVE MJEKËSORE

Neni 44

Ekspozimi mjekësor në situatat e ekspozimit të planifikuar

1. Kërkesat në lidhje me ekspozimin mjekësor në situata të planifikuara të ekspozimit zbatohen për të gjitha ekspozimet mjekësore, përfshirë ekspozimet e planifikuara, të panevojshme dhe aksidentale.

2. Kufijtë e dozës nuk zbatohen për ekspozimet mjekësore.

Neni 45

Përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë ndaj ekspozimit mjekësor

1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron që palët përkatëse, janë të autorizuar të marrin rolin dhe përgjegjësitë e tyre, dhe se nivelet e referencës diagnostike, kufizimet e dozës, kriteret dhe udhëzimet për lirim të pacientëve janë vendosur.

2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron në lidhje me ekspozimet mjekësore që, si rezultat i konsultimit midis autoritetit shëndetësor, organeve përkatëse profesionale dhe organit rregullator, palët përkatëse janë të autorizuar të marrin përsipër rolet dhe përgjegjësitë e tyre, dhe do të sigurojë që ata të njoftohen për detyrat e tyre në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë për individët që i nënshtrohen ekspozimeve mjekësore.

3. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, siguron që, si rezultat i konsultimit midis autoritetit shëndetësor, organeve përkatëse profesionale dhe Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, një grup i niveleve të referencës diagnostike është krijuar për ekspozimet mjekësore të bëra në imazhin mjekësor, përfshirë imazhin nga procedurat ndërhyrëse. Në përcaktimin e niveleve të tilla të referencës diagnostike, merret parasysh nevoja për një cilësi të përshtatshme të imazhit. Nivelet e tilla të referencës diagnostike do të bazohen në anketime në shkallë të gjerë ose në vlera të publikuara që janë të përshtatshme për rrethanat lokale.

4. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, siguron që, si rezultat i konsultimit midis autoritetit shëndetësor, organeve përkatëse profesionale dhe



Komisionit të Mbrojtjes së Rrezatimit, të përcaktohen:

- a) kufizimet e dozës, që përmbushen, për:
 - i. ekspozimet e stafit;
 - ii. ekspozime për shkak të kontrolleve diagnostikuese të vullnetarëve që marrin pjesë në një program të kërkimit biomjekësor;
- b) kriteret dhe udhëzimet për daljen e pacientëve që kanë kaluar procedura radiologjike terapeutike duke përdorur burime radioaktive ose pacientë që mbajnë burime të mbyllura të implantuara.

Neni 46

Përgjegjësitë e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet ndaj ekspozimit mjekësor

1. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet do të kërkojë që profesionistët shëndetësorë me përgjegjësi për ekspozimin mjekësor të specializohen në fushën e duhur dhe që të përmbushin kërkesat për arsim, trajnim dhe kompetencë në specialitetin përkatës.

2. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që autorizimi për ekspozimet mjekësore të kryhet në një strukturë të veçantë rrezatimi mjekësor dhe lejon personelin, praktikues mjekësorë radiologë, fizikanë mjekësorë, teknologë të rrezatimit mjekësor dhe çdo profesionist tjetër shëndetësor me detyra specifike në lidhje me mbrojtjen nga rrezatimi i pacientëve, për të marrë përgjegjësitë e specifikuara në këtë rregullore vetëm nëse:

- a) janë të specializuar në fushën e duhur;
- b) përmbush kërkesat përkatëse për arsim, trajnim dhe kompetencë në mbrojtjen nga rrezatimi;
- c) përcaktohen në një listë e cila mbahet e azhurnuar nga i licencuari.

Neni 47

Përgjegjësitë e të licencuarve ndaj ekspozimit mjekësor

1. Të licencuarit sigurojnë që asnjë person të mos bëjë një ekspozim mjekësor përveç nëse ka pasur një kërkesë të duhur, është marrë përgjegjësia për sigurimin e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe personi që i nënshtrohet ekspozimit është informuar si për përfitimet dhe rreziqet e pritura.

2. Të licencuarit sigurojnë që asnjë pacient,

qoftë simptomatik apo asimptomatik, të pësojë një ekspozim mjekësor përveç rasteve:

a) është një procedurë radiologjike që është kërkuar nga një mjek referues dhe është dhënë informacion mbi kontekstin klinik, ose është pjesë e një programi të aprovuar të kontrollit shëndetësor;

b) ekspozimi mjekësor është justifikuar me anë të konsultimit midis mjekut radiolog dhe mjekut referues, ose është pjesë e një programi të aprovuar të kontrollit shëndetësor;

c) një mjek radiolog ka marrë përsipër përgjegjësinë për mbrojtjen dhe sigurinë në planifikimin dhe shpërndarjen e ekspozimit mjekësor;

ç) pacienti, ose përfaqësuesi i autorizuar ligjor i pacientit është informuar, për përfitimet e pritura diagnostike ose terapeutike të procedurës radiologjike, si dhe rreziqet nga rrezatimi.

3. Të licencuarit sigurojnë që, asnjë individ të mos bëjë një ekspozim mjekësor si pjesë e një programi të hulumtimit biomjekësor, përveç rastit kur ekspozimi është aprovuar nga një komitet etike, (ose një organ tjetër institucional, të cilit i janë caktuar funksione të ngjashme me ato të një komiteti etike nga ana e autoritetit përkatës) siç kërkohej dhe një mjek radiolog ka marrë përsipër përgjegjësitë siç përcaktohet. Të licencuarit sigurojnë që kërkesat të përmbushen për optimizimin e mbrojtjes dhe sigurisë për personat që i nënshtrohen ekspozimit si pjesë e një programi të kërkimit biomjekësor.

3. Të licencuarit sigurojnë që, asnjë individ të mos bëjë një ekspozim mjekësor si staf ose mbështetës përveç rastit kur ai ose ajo ka marrë informacionin përkatës për mbrojtjen nga rrezatimi dhe informacionin mbi rreziqet e rrezatimit përpara se t'i nënshtrohet një procedurë radiologjike. Të licencuarit sigurojnë që kërkesat të përmbushen për optimizimin e mbrojtjes dhe sigurisë për çdo procedurë radiologjike.

5. Të licencuarit sigurojnë, që:

a) mjeku radiolog që kryen, ose mbikëqyr procedurën radiologjike ka marrë përgjegjësinë për të siguruar mbrojtje dhe siguri të përgjithshme për pacientët në planifikimin dhe shpërndarjen e ekspozimit mjekësor, përfshirë arsyetimin e procedurës radiologjike dhe optimizimin e mbrojtjes dhe sigurisë, në bashkëpunim me fizikanin mjekësor dhe teknologun siç kërkohej;



b) praktikantët mjekësorë radiologjikë, fizikanët mjekësorë, teknologët e rrezatimit mjekësor dhe profesionistët e tjerë të shëndetit me detyra specifike në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë për pacientët në një procedurë të caktuar radiologjike janë të specializuar në fushën përkatëse;

c) personeli i mjaftueshëm mjekësor dhe personeli paramjekësor janë në dispozicion siç përcaktohet nga autoriteti shëndetësor;

ç) për procedurat radiologjike terapeutike, kërkesat e kësaj rregulloreje për kalibrimin, dozimetrinë dhe sigurimin e cilësisë, përfshirë pranimin dhe përdorimin e pajisjeve radiologjike mjekësore, përmbushen nga, ose nën mbikëqyrjen e një fizikani mjekësor;

d) për procedurat radiologjike diagnostikuese dhe procedurat ndërhyrëse të drejtuara nga imazhi, kërkesat e kësaj rregulloreje për imazhin mjekësor, kalibrimin, dozimetrinë dhe sigurimin e cilësisë, përfshirë pranimin dhe vënien në përdorim e pajisjeve radiologjike mjekësore përmbushet nën mbikëqyrjen, ose me këshillën e dokumentuar të një fizikani mjekësor, shkalla e përfshirjes së të cilit përcaktohet nga kompleksiteti i procedurave radiologjike dhe rreziqet e rrezatimit shoqërues;

dh) delegimi i përgjegjësive nga një palë kryesore është i dokumentuar.

Neni 48

Justifikimi i ekspozimeve mjekësore

1. Palët përkatëse sigurojnë që ekspozimet mjekësore të jenë të justifikuara.

2. Ekspozimet mjekësore justifikohen duke peshuar përfitimet diagnostikuese ose terapeutike që pritet të sjellin kundër dëmit të rrezatimit që ata mund të shkaktojnë, duke marrë parasysh përfitimet dhe rreziqet e teknikave alternative në dispozicion që nuk përfshijnë ekspozimin mjekësor.

3. Justifikimi i përgjithshëm i një procedure radiologjike do të bëhet nga autoriteti shëndetësor në lidhje me organet e dhura profesionale, dhe do të rishikohet herë pas here, duke marrë parasysh përparimet në njohuritë dhe zhvillimet teknologjike.

4. Justifikimi i ekspozimit mjekësor për një pacient individual do të bëhet me konsultë midis mjekut radiolog dhe mjekut referues, veçanërisht për pacientet që janë shtatzënë ose ushqejnë fëmijën me gjë ose janë pediatrike, mbi:

- a) përshtatshmërinë e kërkesës;
- b) urgjencën e procedurës radiologjike;
- c) karakteristikat e ekspozimit mjekësor;
- ç) karakteristikat individuale të pacientit;
- d) informacion përkatës nga procedurat e mëparshme radiologjike të pacientit.

5. Për arsyetimin e ekspozimit mjekësor të një pacienti individual në një procedurë radiologjike do të merren parasysh udhëzimet përkatëse të referimit kombëtar ose ndërkombëtar.

6. Arsyetimi që, procedurat radiologjike të kryhen si pjesë e një programi të kontrollit shëndetësor për popullatat asimptomatike, do të kryhet nga autoriteti shëndetësor në bashkëpunim me organet e dhura profesionale.

7. Procedurat radiologjike mbi një individ asimptomatik që ka për qëllim të kryhet për zbulimin e hershëm të sëmundjes, por jo si pjesë e një programi të aprovuar të kontrollit shëndetësor, do të kërkojë justifikim specifik për atë individ nga mjeku radiolog dhe mjeku referues, në përputhje me udhëzimet e organeve përkatëse profesionale ose autoritetit shëndetësor. Si pjesë e këtij procesi, individ do të informohet paraprakisht për përfitimet, rreziqet dhe kufizimet e pritura të procedurës radiologjike.

8. Ekspozimi mjekësor i vullnetarëve si pjesë e një programi të hulumtimit biomjekësor konsiderohet se nuk është i justifikuar, përveç nëse ai i nënshtrohet aprovimit nga një komitet etike (ose një organ tjetër institucional, të cilit i janë caktuar funksione të ngjashme me ato të një komiteti etike nga autoriteti përkatës), duke iu nënshtruar çdo kufizimi të dozës që mund të specifikohet, dhe i nënshtrohet zbatueshmërisë me rregulloret kombëtare dhe rregulloret lokale.

Neni 49

Optimizimi i mbrojtjes dhe sigurisë

Të licencuarit dhe praktikuesit mjekësorë radiologjikë sigurojnë që mbrojtja dhe siguria të jenë optimizuar për secilin ekspozim mjekësor.

Neni 50

Konsideratat e projektimit

Të licencuarit, në bashkëpunim me furnitorët, sigurojnë që pajisjet dhe programi radiologjik mjekësor që mund të ndikojnë në shpërndarjen e



ekspozimit mjekësor përdoren vetëm nëse ato përputhen me standardet kombëtare të miratuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Neni 51

Konsideratat operacionale

1. Për procedurat radiologjike diagnostikuese dhe procedurat e ndërhyrjes të drejtuara nga imazhi, mjeku radiolog, në bashkëpunim me teknologun e rrezatimit mjekësor dhe fizikanin mjekësor, dhe nëse është e përshtatshme, me radiofarmacistin ose radiokimistin, siguron që të përdoren:

a) pajisje dhe programe të përshtatshme radiologjike mjekësore, për mjekësinë bërthamore dhe radiofarmaceutikë;

b) teknika dhe parametra të përshtatshme për të ofruar një ekspozim mjekësor të pacientit që është minimumi i nevojshëm për të përmbushur qëllimin klinik të procedurës radiologjike, duke marrë parasysh normat përkatëse të një cilësie të pranueshme të imazhit të vendosur nga organet përkatëse profesionale dhe të referencës përkatëse diagnostikuese, niveleve të përcaktuara në përputhje me kërkesat rregullatore.

2. Për procedurat radiologjike terapeutike, mjeku radiolog, në bashkëpunim me fizikanin mjekësor dhe teknologun e rrezatimit mjekësor, siguron që për secilin pacient ekspozimi i vëllimeve të ndryshëm nga vëllimi i synuar i planifikimit të mbahet aq i ulët sa të arrihet në mënyrë të arsyeshme në përputhje me dozën e përcaktuar në vëllimin e synuar të planifikimit brenda tolerancave të kërkuara.

3. Për procedurat radiologjike terapeutike, në të cilat administrohen radiofarmaceutikët, mjeku radiolog, në bashkëpunim me fizikanin mjekësor dhe teknologun e rrezatimit mjekësor, dhe nëse është e përshtatshme me radiofarmacistin ose radiokimistin, siguron që për secilin pacient radiofarmaceutikati dhe aktivitetin e duhur që përzgjidhet dhe administrohet, në mënyrë që radioaktiviteti kryesisht të lokalizohet në organet e interesit, ndërsa radioaktiviteti në pjesën tjetër të trupit mbahet aq i ulët sa të arrihet në mënyrë të arsyeshme.

4. Të licencuarit sigurojnë që aspektet e veçanta të ekspozimeve mjekësore të merren parasysh në procesin e optimizimit për:

a) pacientët pediatrikë që i nënshtrohen ekspozimit mjekësor;

b) individët që i nënshtrohen ekspozimit mjekësor si pjesë e një programi të aprovuar të kontrollit shëndetësor;

c) vullnetarët që i nënshtrohen ekspozimit mjekësor si pjesë e një programi të kërkimit biomjekësor;

ç) dozat relativisht të larta për pacientin;

d) ekspozimi i embrionit ose fetusit, veçanërisht për procedurat radiologjike, në të cilat barku ose legenit i pacientit shtatzënë është i ekspozuar ndaj rrezes së dobishme të rrezatimit ose mund të marrë ndryshe një dozë të konsiderueshme;

dh) ekspozimi i një foshnje me gjë si rezultat i një pacienteje femër që i është nënshtrohur një procedure radiologjike me radiofarmaceutik.

Neni 52

Kalibrimi

Fizikani mjekësor siguron, që:

a) të gjitha burimet që shkaktojnë ekspozimin mjekësor janë të kalibruar në drejtim të sasive të përshtatshme duke përdorur protokollet ndërkombëtare ose në shkallë vendi;

b) kalibrimet kryhen në kohën e vënies në punë të një njësie para përdorimit klinik, pas çdo procedure mirëmbajtjeje që mund të ndikojë në dozimetritë dhe në intervalet e aprovuara nga organi rregullator;

c) kalibrimet e njëjësive të terapisë së rrezatimit i nënshtrohen verifikimit të pavarur para përdorimit klinik;

ç) kalibrimi i të gjithë dozimetrave të përdorur për dozimetritë e pacientëve dhe për kalibrimin e burimeve është i gjurmueshëm në një laborator të standardeve të dozimetrisë.

Neni 53

Dozimetria e pacientëve

Të licencuarit sigurojnë që dozimetria e pacientëve të kryhet dhe të dokumentohet nga, ose nën mbikëqyrjen e një fizikani mjekësor, duke përdorur dozimetra të kalibruar dhe duke ndjekur ndërkombëtarisht ose në shkallë vendi, protokollet e pranueshme, përfshirë dozimetritë për të përcaktuar:

a) procedurat radiologjike diagnostikuese, doza tipike për pacientët për procedura të zakonshme;



b) procedurat e ndërhyrjes të drejtuara nga imazhi, doza tipike për pacientët;

c) procedurat radiologjike terapeutike, doza të përthithura në vëllimin e synuar të planifikimit për çdo pacient të trajtuar me terapi me rreze të jashtme dhe/ose brakiterapi, dhe doza të larta në indet ose organet përkatëse të përcaktuara nga mjeku radiolog;

ç) procedurat radiologjike terapeutike me burime të hapura, doza tipike të dhëna te pacientët.

Neni 54

Nivelet e referencës diagnostike

Të licencuarit sigurojnë që:

a) vlerësimet lokale, bëhen në interval të aprovuar për ato procedura radiologjike për të cilat janë vendosur nivelet e referencës diagnostike;

b) kryhet një rishikim për të përcaktuar nëse optimizimi i mbrojtjes dhe sigurisë për pacientët është adekuat, apo nëse kërkohet veprim korrigjues për një procedurë të caktuar radiologjike nëse:

i. doza ose aktivitetet tipike tejkalojnë nivelin e duhur të referencës diagnostike;

ii. doza ose aktivitetet tipike bien ndjeshëm nën nivelin përkatës të referencës diagnostikuese dhe ekspozimet nuk japin informacion të dobishëm diagnostikues ose nuk japin përfitimin e pritshëm mjekësor për pacientin.

Neni 55

Sigurimi i cilësisë për ekspozimet mjekësore

1. Të licencuarit, në zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje në lidhje me sistemet e menaxhimit, krijojnë një program gjithëpërfshirës të sigurimit të cilësisë për ekspozimet mjekësore me pjesëmarrjen aktive të fizikanëve mjekësorë, praktikuesve mjekësorë radiologë, teknologëve të rrezatimit mjekësor dhe për lehtësirat komplekse të mjekësisë bërthamore, radiofarmacistët dhe radiokimistët, dhe në bashkëpunim me profesionistë të tjerë shëndetësorë.

2. Të licencuarit sigurojnë që programet e sigurimit të cilësisë për ekspozimin mjekësor të përfshijnë, siç është e përshtatshme, për objektin e rrezatimit mjekësor:

a) matjet e parametrave fizikë të pajisjeve radiologjike mjekësore të bëra nga, ose nën mbikëqyrjen e një fizikani mjekësor:

i. në kohën e pranimit dhe vënies në përdorim të pajisjeve para përdorimit klinik të saj te pacientët;

ii. në mënyrë periodike;

iii. pas çdo procedure kryesore mirëmbajtjeje që mund të ndikojë në mbrojtjen dhe sigurinë e pacientëve;

iv. pas çdo instalimi të një programi kompjuterik të ri ose modifikimit të programit kompjuterik ekzistues që mund të ndikojë në mbrojtjen dhe sigurinë e pacientëve.

b) zbatimi i veprimeve korrigjuese nëse vlerat e matura të parametrave fizikë të përmendura në pikën (a) më lart janë jashtë kufijve të vendosur të tolerancës;

c) verifikimi i faktorëve të duhur fizikë dhe klinikë të përdorur në procedurat radiologjike;

ç) Mbajtja shënim e procedurave dhe rezultateve përkatëse;

d) kontrollet periodike të kalibrimit dhe kushteve të funksionimit të pajisjeve të dozimetrisë dhe pajisjeve monitoruese.

3. Të licencuarit sigurojnë që janë bërë auditime të rregullta dhe të pavarura nga programi i sigurimit të cilësisë për ekspozimet mjekësore, dhe që frekuenca e tyre është në përputhje me kompleksitetin radiologjik, procedurat që kryhen si dhe rreziqet e shoqëruara.

Neni 56

Kufizimet e dozës

Të licencuarit sigurojnë që:

a) kufizimet përkatëse të dozës përdoren në optimizimin e mbrojtjes dhe sigurisë në çdo procedurë radiologjike, në të cilën një individ vepron si mbështetës.

b) kufizimet e dozës të specifikuar ose të aprovuara nga komiteti i etikës (ose ndonjë organ tjetër institucional që ka funksione të caktuara të ngjashme me ato të një komiteti etike nga autoriteti përkatës) rast pas rasti, si pjesë e një propozimi për hulumtime biomjekësore, përdoren në optimizimin e mbrojtjes dhe sigurisë për personat subjekt i ekspozimit si pjesë e një programi të kërkimit biomjekësor.



Neni 57

Pacientet femra shtatzëna ose me fëmijë me gj

1. Të licencuarit sigurojnë që të ketë rregullime për mbrojtjen e duhur nga rrezatimi në rastet kur një paciente femër është ose mund të mbetet shtatzënë, ose po ushqen fëmijën me gj.

2. Të licencuarit sigurojnë që shenjat janë vendosur në gjuhë të përshtatshme në vendet publike, dhomat e pritjes për pacientët, dhe vendet e tjera të përshtatshme, si dhe që përdoren mjetet e tjera të komunikimit, të përshtatshme, për të kërkuar prej pacienteve femra që do t'i nënshtrohen një procedure radiologjike, të njoftojë mjekun radiolog, teknologun e rrezatimit mjekësor ose personelin tjetër në rast se:

a) ajo është, ose mund të mbetet shtatzënë;

b) ajo ushqen me gj fëmijën dhe procedura radiologjike e planifikuar përfshin administrimin e një radiofarmaceutiku;

3. Të licencuarit do të sigurojnë që ekzistojnë procedura për të konstatuar statusin e shtatzënisë së një pacienteje femër me aftësi riprodhuese para kryerjes së ndonjë procedure radiologjike që mund të rezultojë në doza të konsiderueshme për embrionin ose fetusin, në mënyrë që këto informacione të konsiderohen në arsyetimin e procedurës radiologjike dhe në optimizimin e mbrojtjes dhe sigurisë.

4. Të licencuarit sigurojnë që ka kërkesa për të vërtetuar që një paciente femër aktualisht nuk ushqen me gj fëmijën para kryerjes së ndonjë procedure radiologjike që përfshin administrimin e një radiofarmaceutikati që mund të rezultojë në një dozë të konsiderueshme për një foshnjë që ushqehet me gj, në mënyrë që këto informata të mund të konsiderohen në arsyetimin për procedurën radiologjike dhe në optimizimin e mbrojtjes dhe sigurisë.

Neni 58

Nxjerrja nga spitali e pacientëve pas terapisë me radionuklide

1. Të licencuarit sigurojnë që ekzistojnë rregulla për të siguruar mbrojtjen e duhur nga rrezatimi për anëtarët e publikut dhe për anëtarët e familjes përpara se një pacient të nxirret pas terapisë me radionuklide.

2. Mjeku radiolog siguron që asnjë pacient që ka kaluar një procedurë radiologjike terapeutike me një burim të mbyllur ose një burim të hapur, nuk nxirret nga një institucion i rrezatimit mjekësor deri sa të jetë sqaruar nga një fizikan mjekësor, ose nga oficeri i mbrojtjes nga rrezatimi i institucionit, që:

a) aktiviteti i radionuklideve të pacienti është i tillë që dozat që mund të merren nga anëtarët e publikut dhe anëtarët e familjes do të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoritetet përkatëse;

b) pacientit, ose kujdestarit ligjor të pacientit i sigurohet:

i. udhëzime me shkrim për mbajtjen e dozave të personat në kontakt me të, ose në afërsi të pacientit në nivel sa më të ulët dhe për të shmangur përhapjen e ndotjes;

ii. informacion mbi rreziqet e rrezatimit.

Neni 59

Ekspozime mjekësore të padëshiruara dhe aksidentale

1. Të licencuarit sigurojnë që të merren të gjitha masat e zbatueshme për të minimizuar gjasat e ekspozimeve mjekësore të panevojshme ose aksidentale. Të licencuarit do të hetojnë menjëherë ekspozimet mjekësore të panevojshme ose aksidentale dhe, nëse është e përshtatshme, do të ndërmarrin veprime korrigjuese.

2. Të licencuarit, në përputhje me kërkesat rregullatore përkatëse, sigurojnë që të merren të gjitha masat praktike për të minimizuar gjasat e ekspozimeve mjekësore të padëshiruara ose aksidentale që vijnë nga të metat në projektimin dhe dështimet operacionale të pajisjeve radiologjike, nga dështimet dhe gabimet në programin kompjuterik, ose si rezultat i gabimit njerëzor.

Neni 60

Hetimi i ekspozimeve mjekësore të padëshiruara dhe aksidentale

1. I licencuari do të hetojë menjëherë ndonjë nga ekspozimet e mëposhtme të padëshiruara ose aksidentale mjekësore:

a) trajtim mjekësor realizuar një individ të gabuar ose indit, apo organit të gabuar të pacientit, ose duke përdorur radiofarmaceutikatin e gabuar,



ose një aktivitet, pra një dozë ose fraksion i dozës që ndryshon ndjeshëm nga (mbi ose nën) vlerat e përshkruara nga mjeku radiolog, ose që mund të çojnë në efekte dytësore, padrejtësisht të rënda;

b) procedurë radiologjike diagnostikuese ose procedurë ndërhyrëse e udhëhequr nga imazhi, në të cilën një individ i gabuar ose indi i gabuar, apo organi i pacientit i nënshtrohet ekspozimit;

c) ekspozim për qëllime diagnostike që është në thelb më i madh seç ishte menduar;

ç) ekspozim që rrjedh nga një procedurë ndërhyrëse e udhëhequr nga imazhi që është në thelb më e madhe nga sa synohej;

d) ekspozim i panevojshëm i embrionit ose fetusit gjatë kryerjes së një procedure radiologjike;

dh) dështim i pajisjeve mjekësore radiologjike, dështimi i programit kompjuterik ose dështimi i sistemit, apo gabimi ose dukuri tjetër e pazakontë me potencialin për t'ia nënshtrohet pacientit në një ekspozim mjekësor që është thelbësisht ndryshe nga sa synohej;

2. Të licencuarit, në lidhje me çdo ekspozim mjekësor të padëshiruar ose të rastësishëm të hetuar:

a) llogaritin ose vlerësojnë dozat e marra dhe shpërndarjen e dozës brenda trupit të pacientit;

b) tregojnë mbi veprimet korrigjuese të kërkuara për të parandaluar përsëritjen e një ekspozimi të tillë të padëshiruar ose aksidental mjekësor;

c) zbatojnë të gjitha veprimet korrigjuese që janë nën përgjegjësinë e tyre;

ç) prodhojnë dhe të mbajnë, sa më shpejt të jetë e mundur, pas hetimit, ose siç kërkohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, një procesverbal me shkrim, i cili tregon shkaku e ekspozimit mjekësor të panevojshëm ose aksidental dhe përfshin informacionin e specifikuar në pikat (a) - (c) më lart, si të rëndësishme, dhe çdo informacion tjetër siç kërkohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet;

d) për ekspozime të konsiderueshme mjekësore të padëshiruara, ose të rastësishme, ose siç kërkohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, të paraqesin këtë procesverbal me shkrim, sa më shpejt të jetë e mundur, në organin rregullator dhe autoritetin përkatës shëndetësor, nëse është e përshtatshme;

dh) të sigurojnë që mjeku i duhur radiolog të informojë mjekun referues dhe pacientin ose përfaqësuesin e autorizuar ligjor të pacientit për

ekspozimin mjekësor të panevojshëm ose aksidental.

Neni 61

Shqyrtime dhe regjistrime

1. Të licencuarit sigurojnë që rishikimet radiologjike kryhen në mënyrë periodike:

a) në ambientet e rrezatimit mjekësor dhe që të mbahen evidencat;

b) nga mjekët radiologë në institucionin e rrezatimit mjekësor, në bashkëpunim me teknologët e rrezatimit mjekësor dhe fizikanët mjekësorë. Rishikimi radiologjik përfshin një hetim dhe rishikim kritik të zbatimit aktual praktik të parimeve të mbrojtjes nga rrezatimi, i arsytimit dhe optimizmit për procedurat radiologjike që kryhen në objektin e rrezatimit mjekësor.

2. Të licencuarit mbajnë për një periudhë, siç përcaktohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe do të vënë në dispozicion, siç kërkohet, të dhënat e personelit vijues:

a) regjistrat e çdo delegimi të përgjegjësive nga një palë kryesore;

b) procesverbalin e trajnimit të personelit për mbrojtjen nga rrezatimi.

3. Të licencuarit do të mbajnë për një periudhë, siç përcaktohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, dhe do të vënë në dispozicion, siç kërkohet, të dhënat e mëposhtme të kalibrimit, dozimetrisë dhe sigurimit të cilësisë:

a) regjistrime të rezultateve të kalibrimeve dhe kontroleve periodike të parametrave përkatës fizik dhe klinik të zgjedhura gjatë trajtimit të pacientëve;

b) regjistrimet e dozimetrisë së pacientëve;

c) regjistrimet e vlerësimeve lokale dhe rishikimet e bëra në lidhje me nivelet e referencës diagnostike;

ç) regjistrimet që lidhen me programin e sigurimit të cilësisë.

4. Të licencuarit do të mbajnë për një periudhë siç përcaktohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe do të vënë në dispozicion, siç kërkohet, të dhënat e mëposhtme për ekspozimin mjekësor:

a) për radiologjinë diagnostikuese, informacionin e nevojshëm për vlerësimin retrospektiv të dozave, përfshirë numrin e ekspozimeve dhe kohëzgjatjen e procedurave radiologjike fluoroskopike;



Për procedurat e ndërhyrjes të drejtuara nga imazhi, informacionet e nevojshme për vlerësimin retrospektiv të dozave, përfshirë kohëzgjatjen e përbërësit fluoroskopik dhe numrin e imazheve të fituara;

b) për mjekësinë bërthamore, llojet e radiofarmaceutikëve të administruar dhe veprimtarinë e tyre;

c) për terapinë e rrezatimit të rrezeve të jashtme ose brakiterapisë, një përshkrim të

c) vëllimit të synuar të planifikimit, dozën e përthithur në qendër të vëllimit të synuar të planifikimit, dhe dozat maksimale dhe minimale të përthithura të dorëzuara në vëllimin e synuar të planifikimit, ose informacion ekuivalent alternativ mbi doza të përthithura në vëllimin e synuar të planifikimit, dhe dozat e përthithura në indet ose organet përkatëse, siç përcaktohet nga mjeku radiolog; dhe përveç kësaj, për terapinë e rrezatimit të rrezeve të jashtme, fraksionimin e dozës dhe kohën e përgjithshme të trajtimit;

d) regjistrimet e ekspozimit për vullnetarët që i nënshtrohen ekspozimit mjekësor si pjesë e një programi të kërkimit biomjekësor;

dh) raporte mbi hetimin e ekspozimeve mjekësore të padëshiruara dhe aksidentale.

VI. SITUATAT E EKSPOZIMIT TË EMERGJENCËS RADIOLOGJIKE

Neni 62

Situatat e ekspozimit të emergjencës radiologjike

Kërkesat për situatat e ekspozimit të emergjencës zbatohen për aktivitetet e ndërmarrja në gatishmërinë për, dhe në përgjigje të një emergjence bërthamore ose radiologjike.

Neni 63

Sistemi i menaxhimit të emergjencës radiologjike

1. Këshilli Ndërmintor për Emergjencat Civile siguron që të vendoset dhe mirëmbahet një sistem i integruar dhe i koordinuar i menaxhimit të emergjencave.

2. Këshilli Ndërmintor për Emergjencat Civile siguron që një sistem i menaxhimit të emergjencës, të vendoset dhe të zbatohet në territoret dhe në

juridiksionin e Shtetit për qëllime të reagimit emergjent për të mbrojtur jetën e njeriut, shëndetin dhe mjedisin në rast të një emergjence bërthamore ose radiologjike.

3. Sistemi i menaxhimit të emergjencës do të jetë i dizenuar që të jetë në përpjesëtim me rezultatet e një vlerësimi të rrezikut dhe të mundësojë një reagim efektiv emergjent ndaj ngjarjeve të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme (përfshirë ngjarje me probabilitet shumë të ulët) në lidhje me objektet ose aktivitetet.

4. Sistemi i menaxhimit të emergjencës të jetë i integruar, në masën e mundur, në një sistem të menaxhimit të emergjencave për të gjitha rreziqet.

5. Sistemi i menaxhimit të emergjencës do të sigurojë elemente thelbësore në vendngjarje, dhe në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë:

a) vlerësimin e rrezikut;

b) zhvillimin dhe ushtrimin e planeve emergjente dhe procedurave të emergjencës;

c) ndarje e qartë e përgjegjësiave për personat dhe organizatat që kanë role në marrëveshjet për gatishmërinë dhe reagimin ndaj emergjencës;

c) marrëveshjet për bashkëpunim dhe koordinim efikas dhe efektiv midis organizatave;

d) komunikim të besueshëm, përfshirë informacionin publik;

dh) strategjitë e optimizuara të mbrojtjes për zbatimin dhe përfundimin e masave për mbrojtjen e anëtarëve të publikut që mund të jenë subjekt i ekspozimit në raste emergjence, duke përfshirë konsideratat përkatëse për mbrojtjen e mjedisit;

e) marrëveshjet për mbrojtjen e punëmarrësve të emergjencës;

ë) edukimin dhe trajnimin, përfshirë trajnimin për mbrojtjen nga rrezatimi, për të gjithë personat e përfshirë në reagimin e emergjencës dhe ushtrimin e planeve emergjente dhe procedurave të emergjencës;

f) përgatitjet për kalimin nga situata e ekspozimit emergjent në situatën ekzistuese të ekspozimit;

g) marrëveshjet për përgjigjen mjekësore dhe reagimin e shëndetit publik në raste emergjence;

gj) sigurimi për monitorim individual dhe monitorim i substancave radioaktive në mjedis dhe vlerësim të dozës;

h) përfshirjen e palëve përkatëse dhe palëve të interesuara;



6. Këshilli Ndëministor për Emergjencat Civile siguron bashkërendimin e kapaciteteve dhe aftësive të saj në emergjenca, në bashkërendim me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare të emergjencës.

Neni 64

Ekspozimi publik

Të gjitha kërkesat dhe veprimet në lidhje me gatishmërinë dhe reagimin për një emergjencë për shkak të ekspozimit në publik, përcaktohen në rregulloren nr. 700, datë 21.11.2018, “Për përgatitjen dhe reagimin në rast emergjence radiologjike, për mbrojtjen e punëmarrësve dhe publikut”, të ndryshuar.

Neni 65

Ekspozimi i punëmarrësve të emergjencës

Të gjitha kërkesat dhe veprimet në lidhje me rregullimet për kontrollin e ekspozimit të punëmarrësve të emergjencës përcaktohen në rregulloren nr. 700, datë 21.11.2018, “Për gatishmërinë dhe përgjigjen në rast emergjence radiologjike për mbrojtjen e publikut dhe punëmarrësve”, të ndryshuar.

Neni 66

Marrëveshjet për kalimin nga një situatë e ekspozimit emergjent në një situatë ekzistuese të ekspozimit

1. Këshilli Ndëministor për Emergjencat Civile siguron që ekzistojnë masat dhe zbatohen siç është e përshtatshme për kalimin nga një situatë e ekspozimit emergjent në një situatë ekzistuese të ekspozimit.

2. Këshilli Ndëministor për Emergjencat Civile siguron që, si pjesë e gatishmërisë së saj të përgjithshme për emergjencat, të ketë kërkesa për kalimin nga një situatë e ekspozimit emergjent në një situatë ekzistuese të ekspozimit. Marrëveshjet do të marrin parasysh që zona të ndryshme gjeografike mund të pësojnë kalimin në periudha të ndryshme. Autoriteti përgjegjës merr vendimin për të bërë kalimin në një situatë ekzistuese të ekspozimit. Tranzicioni do të bëhet në një mënyrë të koordinuar dhe të rregullt, duke bërë çdo transferim të nevojshëm të përgjegjësive midis

organizatave, me përfshirjen e autoriteteve përkatëse dhe palëve të interesuara.

3. Punëmarrësit që ndërmarrin punë të tilla si riparimin e ndërtesave ose aktiviteteve për menaxhimin e mbetjeve radioaktive, ose ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese për ndotjen e objektit dhe zonave përreth, do t'i nënshtrohen kërkesave përkatëse për ekspozimin profesional në situata të planifikuara të ekspozimit.

VII. SITUATAT EKZISTUESE TË EKSPOZIMIT NDAJ RREZATIMIT JONIZUES

Neni 67

Situatat ekzistuese të ekspozimit për publikun dhe punëmarrësit

1. Kërkesat për situatat ekzistuese të ekspozimit zbatohen, për:

a) ekspozimin për shkak të ndotjes së zonave nga materiali radioaktiv i mbetur që rrjedh nga:

i. aktivitetet e kaluara që kurrë nuk ishin subjekt i kontrollit rregullator ose që i nënshtroheshin kontrollit rregullator, por jo në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

ii. një emergjencë bërthamore ose radiologjike, e cila është deklaruar se ka përfunduar;

b) ekspozimi për shkak të mallrave, përfshirë ushqimin, ujin e pijshëm dhe materialet e ndërtimit, që përfshijnë radionuklidet që rrjedhin nga materiali radioaktiv i mbetur.

c) ekspozimi për shkak të burimeve natyrore, përfshirë:

i. ²²²Rn dhe pasardhësit e tij dhe ²²⁰Rn dhe pasardhësit e tij, në vendet e punës, përveç vendeve të punës për të cilat ekspozimi për shkak të radionuklideve të tjera në zinxhirin e zbërthimit të uraniumit ose zinxhirin e zbërthimit të toriumit kontrollohet si një situatë e planifikuar e ekspozimit, në banesa dhe në ndërtesa të tjera me faktorë të lartë okupimi për anëtarët e publikut;

ii. radionuklidet me origjinë natyrore, pavarësisht nga përqendrimi i aktivitetit, në mallra, përfshirë ushqimin, ujin e pijshëm, produktet plehëruese, ndryshimet e tokës, materialet e ndërtimit dhe materialin e mbetur radioaktiv në mjedis;

iii. materialet, përveç atyre të përcaktuara në pikën (c) (ii) më lart, në të cilat përqendrimi i



aktivitetit të asnjë radionuklidi në zinxhirin e prishjes së uraniumit ose zinxhirin e zbërthimit të toriumit tejkalon 1Bq/g dhe përqendrimi i aktivitetit të 40K nuk tejkalon 10 Bq/g;

iv. ekspozimi i stafit në fluturimet ajrore.

Neni 68

Përgjegjësitë e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet ndaj situatave ekzistuese të ekspozimit

1. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që situatat ekzistuese të ekspozimit të cilat janë identifikuar, janë vlerësuar për të përcaktuar se cilat ekspozime profesionale dhe ekspozime publike janë shqetësuese nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi.

2. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që, kur identifikohet një situatë ekzistuese e ekspozimit, caktohen përgjegjësi për mbrojtjen dhe sigurinë dhe përcaktohen nivelet e duhura të referencës.

3. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet do të përfshijë në kornizën ligjore dhe rregullatore mbrojtjen dhe sigurimin e menaxhimit të situatave ekzistuese të ekspozimit. Në kornizën ligjore dhe rregullatore:

a) do të specifikojë situatat e ekspozimit që përfshihen në fushën e situatave ekzistuese të ekspozimit;

b) do të specifikojë parimet e përgjithshme që përmbajnë strategjitë e mbrojtjes të zhvilluara për të zvogëluar ekspozimin kur veprimet përmirësuese dhe veprimet mbrojtëse janë përcaktuar të justifikuara;

c) do të caktojë përgjegjësitë për krijimin dhe zbatimin e strategjive të mbrojtjes nga organi rregullator, autoritetet dhe sipas rastit, të licencuarit dhe palët e tjera të përfshira në zbatimin e veprimeve përmirësuese dhe veprimeve mbrojtëse;

ç) do të sigurojë përfshirjen e palëve të interesuara në vendime në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të mbrojtjes, sipas rastit.

4. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, i caktuar për të krijuar një strategji mbrojtëse për një situatë ekzistuese të ekspozimit do të specifikojë:

a) objektivat që do të arrihen me anë të strategjisë së mbrojtjes;

b) nivele të përshtatshme referimi.

5. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet do të zbatojë strategjinë e mbrojtjes, duke përfshirë:

a) masat për vlerësimin e veprimeve përmirësuese në dispozicion dhe veprimeve mbrojtëse për arritjen e objektivave dhe vlerësimin e efikasitetit të veprimeve të planifikuara dhe të zbatuara;

b) sigurimin se informacioni është i disponueshëm për individët që i nënshtrohen ekspozimit ndaj rreziqeve të mundshme shëndetësore dhe mjeteve të mundshme për zvogëlimin e ekspozimit të tyre dhe rreziqet e shoqëruara.

Neni 69

Ekspozimi i publikut në situatat ekzistuese të ekspozimit

Kërkesat në lidhje me ekspozimin e publikut në situatat ekzistuese të ekspozimit, zbatohen për çdo ekspozim publik që rrjedh nga situatat siç përcaktohet në këtë rregullore.

Neni 70

Justifikimi i veprimeve mbrojtëse dhe optimizimi i mbrojtjes dhe sigurisë

1. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që veprimet përmirësuese dhe veprimet mbrojtëse të jenë të justifikuara dhe që mbrojtja dhe siguria të optimizohen.

2. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që strategjia e mbrojtjes për menaxhimin e situatave ekzistuese të ekspozimit, të jetë në përpjesëtim me rreziqet e rrezatimit që lidhen me situatën ekzistuese të ekspozimit, dhe veprimet përmirësuese ose veprimet mbrojtëse pritet të japin përfitime të mjaftueshme për të tejkaluar dëmet që lidhen me marrjen e tyre, përfshirë dëmet në formën e rreziqeve nga rrezatimi.

3. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe palët e tjera përgjegjëse për veprime përmirësuese ose veprime mbrojtëse sigurojnë që forma, shkalla dhe kohëzgjatja e veprimeve të tilla të jenë optimizuar. Ndërsa ky proces i optimizimit ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të optimizuar për të gjithë individët që i nënshtrohen ekspozimit, përparësi do t'u jepet atyre grupeve për të cilët doza tejkalon nivelin e referencës. Do të ndërmerren të gjithë hapat e arsyeshëm për të parandaluar që dozat të mbeten mbi nivelet e referencës



4. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet rishikon në mënyrë periodike nivelet e referencës për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme në varësi të rrethanave mbizotëruese.

Neni 71

Përgjegjësitë për rehabilitimin e zonave me material radioaktiv të mbetur

1. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që ka një dispozitë për identifikimin e atyre personave fizikë ose juridikë përgjegjës për zonat me material radioaktiv të mbetur, për krijimin dhe zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe masave të kontrollit pas rehabilitimit, nëse është e përshtatshme, dhe për të krijuar një strategji të përshtatshme për administrimin e mbetjeve radioaktive.

2. Për rregullimin e zonave me materiale radioaktive të mbetura që rrjedhin nga aktivitetet e kaluara ose emergjenca radiologjike, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që të vendosen dispozita në kornizën për mbrojtje dhe siguri, për:

a) identifikimin e personit fizik ose juridik përgjegjës për ndotjen e zonave dhe të atyre që janë përgjegjës për financimin e programit të rehabilitimit, dhe përcaktimin e masave të përshtatshme për burime alternative të financimit nëse persona të tillë fizikë ose juridikë nuk janë më të pranishëm ose nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre;

b) përcaktimin e personit fizik ose juridik përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe verifikimin e rezultateve të veprimeve përmirësuese;

c) vendosjen e çdo kufizimi në përdorimin ose hyrjen në zonat në fjalë para, gjatë dhe, nëse është e nevojshme, pas rehabilitimit;

ç) një sistem të përshtatshëm për ruajtjen, marrjen dhe ndryshimin e regjistrave që mbulojnë natyrën dhe shtrirjen e ndotjes; vendimet e marra para, gjatë dhe pas korrigjimit; dhe informacione për verifikimin e rezultateve të veprimeve përmirësuese, përfshirë rezultatet e të gjitha programeve të monitorimit pas përfundimit të veprimeve përmirësuese.

3. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet siguron që të jetë krijuar një strategji për administrimin e mbetjeve radioaktive për të trajtuar mbetjet që rrjedhin nga veprimet përmirësuese dhe se

dispozita për një strategji të tillë është bërë në kornizën për mbrojtjen dhe sigurinë.

4. Personi fizik ose juridik përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe verifikimin e veprimeve përmirësuese siguron:

a) një plan veprimi korrigjues, i mbështetur nga një vlerësim i sigurisë, përgatitet dhe i paraqitet Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimet për miratim;

b) plani i veprimit korrigjues ka për qëllim zvogëlimin në kohë dhe progresiv të rreziqeve të rrezatimit dhe përfundimisht, nëse është e mundur, në heqjen e kufizimeve për përdorimin ose hyrjen në zonë;

c) çdo dozë shtesë e marrë nga anëtarët e publikut si rezultat i veprimeve përmirësuese justifikohet në bazë të përfitimit neto që rezulton, duke përfshirë konsiderimin e uljes pasuese të dozës vjetore;

ç) zgjedhjen e opsionit të optimizuar të rehabilitimit;

d) ndikimet radiologjike mbi njerëzit dhe mjedisin konsiderohen së bashku me ndikimet joradiologjike në njerëz dhe mjedis, me faktorët teknikë, shoqërorë dhe ekonomikë;

dh) merren e konsideratë, shpenzimet e transportit dhe administrimit të mbetjeve radioaktive, ekspozimi nga rrezatimi dhe rreziqet shëndetësore për punonjësit që administrojnë mbetjet radioaktive dhe çdo ekspozim i mëvonshëm publik të lidhur me asgjësimin e saj;

e) një mekanizëm për informimin e publikut dhe palët e interesuara që janë të përfshira në planifikimin, zbatimin dhe verifikimin e veprimeve përmirësuese, duke përfshirë çdo monitorim pas korrigjimit;

ë) një program monitorimi është krijuar dhe zbatuar;

f) një sistem për mbajtjen e regjistrave adekuat në lidhje me situatën ekzistuese të ekspozimit dhe veprimet e ndërmarra për mbrojtje dhe siguri është krijuar;

g) procedurat janë krijuar për t'i raportuar Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për çdo kusht jonormal që ka të bëjë me mbrojtjen dhe sigurinë;

5. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, merr përgjegjësi, për:

a) shqyrtimin e vlerësimit të sigurisë të paraqitur nga personi përgjegjës ose organizata, miratimi i



planit të veprimit korrigjues dhe i çdo ndryshimi pasues në planin e veprimit përmirësues, si dhe dhënien e çdo autorizimi të nevojshëm;

b) vendosjen e kriterëve dhe metodave për vlerësimin e sigurisë;

c) rishikimin e procedurave të punës, programeve të monitorimit dhe regjistrave;

